

PETRO KORÇARI

KRYEARKITEKT
I ALI PASHË
TËPELENËS

BIBLIOTENË
SHËTETIT

92

PSS

DH. S. SHUTERIQI



92
P. 85

DH. S. SHUTERIQI

PETRO KORÇARI

kryearkitekt

i ALI PASHË TEPELENËS



SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

I. H Y R J E

Interesat historiko-kulturore na kanë shtyrë t'u drejtohemi botimeve të kohës së Ali pashë Tepelenës mbi Shqipërinë dhe mbi sundimtarin e Janinës vetë. Kështu e solli rasti që të hasim edhe në emrin e një kryearkitekti shqiptar, të tepelenasit, inxhinier Petro Korçari.

Ky emër, gati krejt i panjohur gjer dje nga ata që merren me historinë e artit shqiptar, tërheq vëmendjen, sepse, sikundër dihet, pak e aspak emra na kanë arritur prej arkitektëve tanë të qindvjetëve të kaluar. Zakonisht përmenden dy a tri prej tyre, si durrsaku Aleks, i shek. XV, apo Mehmet Elbasani dhe arkitekt Sinani, të shek. XVI. Ndërsa i pari ushtroi në viset dalmate dhe në Italinë veriore, dhe dy të tjerët në Stamboll e në Turqi, për asnjërin nuk dihet që të ketë ushtruar edhe në Shqipëri, nëse përjashtojmë ndonjë gojëdhënë, si ajo e Vlorës, për një xhami të këtij qyteti.

Botuam mbi Petro Korçarin një artikull të shkurtër¹, me informatat e pakta të nxjerra nga autori anglez i pjesës së parë të shekullit të kaluar, Ulliam Martin Lik, informata që gjenden në veprën e tij «*Udhëtime në Greqinë e Veriut*»², dhe i premtuam vetes të kërkojmë edhe më tej për kryearkitektin e Ali pashë Tepelenës, duke qenë të bindur se ishte fjala për të vënë në pah vlera kulturore jo të zakonshme të së kaluarës së popullit tonë. Kërkimet

s'qenë pa rezultate dhe këto rezultate janë të kënaqshme, mund të themi, ndonëse do të kishim lakmuar që të qenë më të frutshme. Por edhe ne u kufizuar gati vetëm në letërsinë më të njohur mbi Ali pashë Tepelenën dhe Shqipërinë e kohës së sundimit të tij, kurse letërsia mbi to është e gjerë shumë. Sidoqoftë, lënda e grumbulluar është e tillë, që e lejon një studim paraqitës për inxhinier Petro Korçarin, dhe ky është qëllimi i këtyre pak kapitujve.

Mbi vetë Petron kemi vetëm tri-katër dëshmi të kohës³. Për fat të keq, sepse jeta e tij, edhe me kaq pak sa dimë, duket shumë interesante. Po, nga ana tjetër, ekzistojnë mjaft të dhëna mbi ndërtimet që janë bërë gjatë kohës kur kryemjeshtri punonte pranë Aliut, dhe ato japin mundësi për të formuar një ide, sot për sot të mjaftueshme, mbi ndërtimet e kryera nën drejtimin e tij. Prapë duhet thënë që këtu, se nuk dimë cili nga ndërtimet që ai drejtoi është projektuar prej atij vetë. Megjithëkëtë, që kur Petro Korçari ishte kryearkitekt, ai ishte edhe një konceptues i veprave që drejtonte. Veprat e ngritura nën drejtimin e një kryearkitekti janë, zakonisht, edhe veprat e atij vetë, pavarësisht nëse ai ka qenë apo jo edhe projektuesi i tyre. Ato mbajnë vulën e mendimit krijues dhe të mjeshtërisë së tij.

II. ALI PASHË TEPELENA. KOHA E TIJ DHE PASIONI I TIJ MBI NDËRTIMET

Koha e Ali pashë Tepelënës, në kapërcyell midis dy shekujve XVIII e XIX, është e njohur dhe pak do të ndalemi këtu në historinë e saj⁴. Ali pasha, përbrenda perandorisë osmane, arriti të krijonte një shtet të madh feudal, shtet që ishte i centralizuar fort e mbi të cilin sundoi si autokrat tepelenas, duke e pyetur pak e më pak sulltanin, duke iu bindur pak e aspak atij.

Shteti i Ali pashës, me kryeqendër apo kryeqytet Janinën, quhet përgjithësisht Pashallëku i Janinës. Me këtë emër ai shtet ka hyrë në historiografi. Po bashkëkohësit e kanë quajtur më shumë *Shqipëri*⁵, sepse shqiptarët përbënin një pjesë të madhe të popullatës dhe sepse ata sundonin efektivisht në të, me në krye tepelenasin.

Ali pasha zotëroi një trevë të gjerë, e cila përfshinte gjithë Shqipërinë e Jugut, duke nisur nga kufiri natyral i saj, lumi i Shkumbinit, dhe që shtrihet gjer në fund të gadishullit të Peloponezit (More), duke përfshirë kështu edhe një pjesë të madhe të Greqisë kontinentale. Në ishujt grekë të Jonit dhe në atë të detit Egje, kryezoti i Janinës nuk arriti dot të vinte këmbë, megjithëse disa prej tyre, sepse i kishte fill e përtej brigjeve në të cilat Aliu zotëronte, ai i lakmoi fort: kështu Korfuzin dhe Leukadën (Santë Maura).

Zyrtarisht, Ali pashë Tepelena ishte vetëm zot i Pashallëkut të Janinës, që kishte një shtrirje sado kudo të hapët, por edhe të kufizuar, në krahasim me trevën për të cilën folëm. Porse bijtë e tij, Myftari, Veliu dhe pastaj edhe më i vogli, Saliu, ishin edhe ata zotër në pashallëqe të tjerë në Jugë e në Veri të Pashallëkut të Janinës, kurse, ndaj t'et, djemtë ishin të bindur si zotërit të kryezoti, duke i dhënë atij hesap për të tëra dhe duke e dëgjuar atë për të tëra, ashtu sikundër se bënë ndaj sulltanit. Në këtë mënyrë, Ali pasha qe, në fakt, zot i një vendi shumë më të madh se pashallëku i tij. Andaj edhe ta quash shtetin e zotëruar prej tij ngushtësisht Pashallëk të Janinës, ky nuk na tingëllon një emërtim sa duhet i saktë: fuqia dhe pushteti i tepelenasit ishin shumë të mëdha, shteti i tij shumë më i hapët.

Në shtetin e vezirit shqiptar përmblihdeshin qytete si Elbasani, Ohri, Korça, Berati, Gjirokastra, Delvina, Përmeti, Konica, Kosturi, Filati, Janina, Paramithia, Arta, Trikala, Larisa, Lamia, Argosi, Tripolice etj. Ai kishte porte Durrsin, Vlorën, Butrintin, Prevezën, Pargën, Volosin, Patrën, Nauplian, e të tjerë, si këta ose më të vegjël se këta. Në të përmblihdeshin fusha si Myzeqeja në Shqipëri apo Thesalia në Greqi. Vendi ishte i pasur në burime ekonomike dhe jo keq i shfrytëzuar për kohën në Ballkan e në Turqi. Gjithë ajo trevë kishte një ekonomi të lulëzuar për kohën dhe Ali pashë Tepelena inkurajoi veçanërisht tregtinë, artizanatin, fillimet e industrisë manufakturore, prodhimin e drithrave, të pambukut, orizit, duhanit etj. Ai e nxiti shumë eksport-importin dhe bilanci ishte kurdoherë në favor të vendit e të kasës së shtetit. Ali pasha e zhduku në sundimet e tij anarkinë e madhe feudale që

kishte pllakosur e që dëmtoi aq keq Ballkanin gjatë shek. XVIII. Ai siguroi qetësinë e brendshme dhe e siguroi në të tillë mënyrë, që vjershëtori i tij i oborrit, Haxhi Shehreti, shkruante me të drejtë se, në viset e sunduara nga Ali pasha, «qengji mund të flinte pa frikë pranë ujkut»⁶. Veziri ndërtoi e përmirësoi rrugë të shumta dhe skela, gjë që e kërkonte dhe e nxiste zhvillimi i ekonomisë.

Ali pashë Tepelena ishte një autokrat me të vërtetë mjaft i pavarur nga pushteti qendror osman. Ai e njihte autoritetin e sulltanit dhe i paguante në rregull detyrimet financiare që kishte kundrejt tij. Edhe nderin në dukje ia mbante. Po detyrimet ushtarake i shkelte dhe, në viset ku ishte kryezot, autoritete turke gati s'kishte më. Kjo nuk shkonte pa fërkime të heshtura ose dhe të zhurmshme me Portën e Lartë. Porta pati bërë edhe kërcënime, pati provuar ndonjëherë të merrte edhe masa të rrepta kundër pak të bindurit shqiptar, si, p.sh., në vitin 1812, po nuk arriti t'i zbatonte. Sulltani e gjeti veten më në fund të shpenguar dhe rastin të volitshëm, për ta shpallur rebelin përfundimisht «fermanlli» (jashtë ligjit) e për të dyndur kundër tij ushtritë. Ai e shkarkoi Aliu nga tërë funksionet që i kishte njohur dhe nisi luftën. Kjo luftë, e cila zgjati prej korrikut 1820 e gjer në shkurt të vitit 1822, plot tetëmbëdhjetë muaj, mbaroi me thyerjen dhe vrasjen e Aliut, si dhe me zhdukjen e shtetit që ai kishte ngritur përbrenda perandorisë.

Synimi i kryezotit shqiptar, që të bashkonte gjithë Shqipërinë, Jug e Veri, si dhe pjesët e Greqisë që ai kishte nën vete, për t'u shpallur sundimtar krejt i pavarur, mbret, nuk u arrit. Po qëndresa e

tij qe e rëndësishme në historinë e përpjekjeve të shqiptarëve për t'u çliruar nga sundimi osman e për të krijuar shtetin e tyre të lirë. Pasojat qenë pozitive për qëndresën e mëpastajme të popullit tonë kundër perandorisë së sulltanëve dhe për zhvillimin e përpjekjeve të reja për t'u shkëputur nga Turqia, gjë që e realizoi Rilindja kombëtare më 1912.

Jehona e qëndresës së Aliut të Tepelenës qe e madhe në botën e kohës dhe veprimtaria e tij ndikoi për të shpejtuar rrokullisjen e perandorisë osmane. Ajo i dha dorë lëvizjes së çlirimit të popujve të ndryshëm të Ballkanit, veçanërisht plasjes së revolucionit borgjez grek (1821) dhe çlirimit të Greqisë.


*
* *
*

Zhvillimi ekonomik i vendit dhe nevoja e fuqizimit të tij bënë që, në shtetin e Ali pashë Tepelenës, të njihte një zhvillim të jashtëzakonshëm puna me ndërtimet, arkitektura në përgjithësi. Kjo ngjau sidomos në ato krahina ku veziri sundonte më për së afërmi, nga Tepelena në Artë. Atje Aliu e kishte qendrën e tij të preferuar, sepse aty e kishte edhe forcën më të madhe ushtarake dhe të besimit, prej andej i rekrutonte veçanërisht trupat, që përbeheshin nga shqiptarët, aty kish besim se mund t'i qëndronte më mirë rrezikut që i kërcënohej nga sulltani.

Aliu vetë kishte pasionin e ndërtimeve. Ky pasion ishte i tillë, që pashai të bënte në masë, dhe kudo në të njëjtën kohë, ndërtime nga më të ndry-




Ali pashë Tepelena Viz. Dupre (bot. Rëmerand)




Tepelena, — kështjella, pallati etj. 1815 (bot. Holland)

Tepelena, — kështjella, gjendja e rënuar e pallatit,
etj. Viz. Lir 1848 (bot. po ky)





Tepelena, — kështjella sot (foto Instituti Monumenteve).




Janina, — viz. Kokrell 1813 (bot. Hjuz 1820); — majtas, ansambli i Litharicit, djathtas Kastroja.



Janina, — viz. i kohës së Ali Fashës (bot. Polmer), — majtas; ansambli i Litharicit, djathtas Kastroja, në mes (shënuar me kryq) Qoshkū buzë ujit; dy personazhe të panjohur të kohës.

Janina, — viz. Riçard, 1814 (bot: Rëmerand) — në të djathtë Kastroja, në fund duhet pak ansambli i Litharicit.



shmet, të mëdha e të vogla, ushtarake e civile, duke u qëndruar punimeve përsipër vetë, me një këmbëngulje të habitshme. Ngutja për të ndërtuar apo rindërtuar sa më shumë kështjella e pircje shpjegohet me synimet e tepelenasit për të qenë sa më autonom, ashtu siç arriti të bëhet, e për t'u shpallur sa më shpejt i pavarur. Andaj edhe shteti i tij duhej fortifikuar dhe Aliu nuk la qytet, ngushticë e vend strategjik pa një fortifikatë të madhe apo të vogël, që nga kështjellat, si ato të Janinës, Tepelenës, Gjirokastrës e Prevezës me të tjera, gjer te pircjet më të thjeshta në male, fusha e bregdet. Veç (kështjellave) që përmendëm, ai ngriti ose ringriti të tilla më të vogla edhe në Përmet, Porto Palermo, Butrint e Artë, dhe përmirësoi e zgjeroi fortifikatat ekzistuese në kaq vende. Pasi shtiu në dorë Sulin me lufta të përgjakshme (1803), tepelenasi synoi të bënte në atë malësi qendrën e tij më të fortifikuar të qëndresës në rast rreziku.

Fransoa Pukvili, «konsulli i përgjithshëm i Francës në Shqipëri» (siç e kishte ai ofiqin zyrtar), na dëshmon për këtë⁷ dhe gjithashtu tregon sesi vezir Aliu, jetonte midis një luksi «që s'mund të krahasohej veçse me ndikimin që ai ushtronte në gjithë Turqinë»⁸. Veziri ngriti pallate (saraje) madhështorë në Janinë, Tepelenë, Prevezë, dhe pallate të tjerë në shumë qytete të Jugut të Shqipërisë e të Veriut të Greqisë, por edhe në disa fshatra të këtyre viseve, sidomos përreth Janinës.

Për punën që bëri me ndërtimet, punë, e cila mund të quhet vërtet kolosale nga vëllimi, dhe për kohën prej jo më shumë se tri dekadash gjatë së cilës ajo u krye, — Aliu e mori pushtetin në Janinë më 1788, — pashai përdori një numër të madh

arkitektësh, inxhinierësh, e mjeshtrish të ndryshëm, prej të cilëve na kanë arritur pak emra.

Një pjesë e arkitektëve dhe inxhinierëve të tepelenasit qenë të huaj, si francezët, që i kishte zënë robër më 1798 dhe që u morën fill pastaj me fortifikimin e Prezvezës⁹, apo si koloneli francez Vodonkur, që u muar me të njëjtin fortifikim dhe me atë të kështjellave të Janinës më 1806-7¹⁰, apo alzasiani i myslimanizuar, Ibrahim Manzuri, që i shërbeu Aliut në vitet 1816-19 dhe që thotë se ishte në krye të ndërtimeve ushtarake të vezirit¹¹. E pakta që nga viti 1814, Aliu kishte si «inxhinier kryesor» (kryearkitekt) sicilianin Santo Monteleone, njeri i paaftë¹². Inxhinieri italian nga emri, Inkiostro, punoi për të në sistemimin e kanalit të Artës¹³. Ali pasha kishte sjellë nga Viena, rreth vitit 1812, një specialist të çmuar, Frejvaldin, që ishte kryearkitekt civil i Moravisë dhe që i shërbeu atij pak vjet, bashkë me një stukator, ky i fundit për zbukurimet në punime allçiri të pallateve¹⁴.

Me sa dëshmojnë autorë të ndryshëm, Aliu nuk qe dhe kaq dorëmbarë në zgjedhjen e arkitektëve dhe të inxhinierëve. Kështu, ndërtimin e pallatit të tij në kështjellën e Përmetit e bënte inxhinieri kalabres Kareto, i myslimanizuar e i quajtur Sulejman, që pak mernte vesh nga ajo punë dhe që veziri e liroi më 1818; ai i kishte shërbyer Ali pashës e pakta që nga viti 1804.¹⁵ Për rrugët e vezirit pati punuar disa kohë një mjek napolitan i vetëquajtur inxhinier¹⁶.

Ali pasha nuk u kishte fort besim inxhinierëve dhe arkitektëve të tij të huaj, sado t'u çmonte aftësitë; ai edhe u ndërhynte shpesh në punë¹⁷. Ai s'u ka besuar francezëve dhe më fort Vodonkurit¹⁸, i cili

ka lënë edhe një libër me interes mbi Ishujt Jonianë dhe mbi Ali pashë Tepelenën vetë (1816). Aty, Vodonkuri nuk flet përgjithësisht mirë për ndërtimet që bënte sundimtari i Janinës e për marrëdhëniet e këtij me inxhinierët e arkitektët e huaj. Këtë bën edhe Pukvili. Të dy këta, pavarësisht vërejtjeve edhe të drejtave që kishin për ndërtimet e vezirit, të cilat bëheshin me ngut dhe shpesh me angari, ose me mëditës të paguar keq, ushqyen, siç do ta shohim, një mllef të vërtetë ndaj Aliut. Po, sigurisht, aty kanë ndërhyrë edhe konceptet mbi ndërtimet, kanë ndërhyrë edhe shijet personale, krahasimet që vetvetiu autorët e përmendur bënin me arkitekturën e viseve nga ata vinin. Prapë, Vodonkurit, si dhe Pukvilit, siç do ta shohim, s'kanë mundur të mos u shpëtojnë edhe shprehjet e admirimit për disa nga ndërtimet e Ali pashës¹⁹.

Autorë të tjerë, që edhe s'patën fërkime me kryezotin shqiptar, si J. C. Hobhauz, H. Holland apo S. T. Hjuze, anglezë, janë treguar më admirues për arkitekturën tonë të kohës, për kështjellat e pallatet e Ali pashës,²⁰ ndonëse nuk kanë heshtur për vërejtjet që kishin, sidomos i treti²¹.

Tepelanasia është shërbyer në radhë të parë e në masë nga ndërtuesit shqiptarë, por edhe grekë e vllahë²¹ a të krahinave mbi të cilat ai sundonte. Mjeshtrit shqiptarë ishin të njohur e të çmuar shumë në tërë perandorinë turke, veçanërisht në Stamboll²². Ali pasha përdorte mjeshtrit e krahinave të Korçës, Përmetit, Gjirokastrës e Janinës, por edhe ata të ndonjë krahine të Veriut të Shqipërisë, ku ndjehej ndikimi i tij, si Dibra. Kjo ka rëndësi të nënvizohet për karakterizimin e ndërtimeve që bënte tepelanasia dhe për vlerat autoktonte të arkitek-

turës që mbisundonte në ndërtimet e tij. Pohimi që ndonjëherë vizituesit perëndimorë të Shqipërisë bëjnë për arkitekturën e kështjellave dhe kryesisht të pallateve të Aliut, duke i quajtur të «*stilit turk*»²³, nuk do marrë në mënyrë literale. Ata të huaj s'ishin zakonisht në gjendje të bëjnë mirë dallimin midis arkitekturave të ndryshme të perandorisë turke dhe të Ballkanit, dhe t'i japin ç'i përkiste ndikimit oriental mbi arkitekturën në zotërimet e Ali pashës, në Shqipëri dhe në Greqi. Edhe zbukurimi i jashtëm e sidomos ai i brendshëm i pallateve të vezirit apo mobilimi i tyre kishte nga disa anë, karakterin oriental, pra ndikonte në gjykimet e perëndimorëve mbi arkitekturën vetë të ndërtimeve të vezirit.

III. JETA E PETRO KORÇARIT

Kryearkitektin shqiptar të Ali pashë Tepelenës e përmend për herë të parë Liku, i cili në vitet 1807-10, qëndroi pranë Aliut si këshilltar ushtarak²⁴, pasi kishte vizituar një herë Shqipërinë dhe Greqinë më 1805. Ai ishte albanologu më serioz i pjesës së parë të shekullit, i krahasuar edhe me francezin Pukvil.

Ndërsa Pukvili qëndron mbi Likun me mori-në e jashtëzakonshme të dëshmimeve që na kanë lënë dhe të vëzhgimeve që ka bërë në Shqipëri, prapë ai rrëmbëhet nga armiqësia që ushqen ndaj Ali pashës që në fillimet e njohjes me të, në vitet 1798-1801, po sidomos me prishjen përfundimtare të sundimitarit shqiptar me Napoleon Bonapartin, në vitin 1811. Ndërsa vepra e parë e Pukvilit, «*Udhëtim në More, në Konstantinopël e në Shqipëri*», e botuar më 1805, i sheh përgjithësisht me objektivitete shumë çështje të Shqipërisë, veprat e tij të botuara më pas, «*Udhëtim në Greqi*», 1820, dhe «*Histori e ripërtëritjes së Greqisë*», 1827, s'e fshehin antipatinë e tij ndaj Aliut të Tepelenës, disa herë edhe ndaj popullit tonë, gjë që arrin të bëhet vende-vende manifestive. Këtë antipati, Pukvili s'ia kursen as kryearkitektit të Aliut, Petro Korçarit. Porse ndryshe ka bërë përpara tij Liku.

Ky studiues na ka siguruar, në tri pasazhe të shkurtra, të dhënat thujtase të vetme që kemi mbi

Petro Korçarin dhe, sadopak, na ka vizatuar edhe portretin e tij moral²⁵. Liku e quan atë «*Petroja nga Korça*» (*Peter of Korytzà*) të trija herët që ia përmend emrin të plotë. Ndërsa Pukvili i thotë «*Mjeshtri — Petro, shqiptar nga Përmeti*»²⁶, Vodonkuri e përmend si «*një shqiptar me emrin Petro*»²⁷.

S'ka dyshim se nuk duhet mbajtur te Pukvili për origjinën përmetare, pra jo korçare, të kryemjeshtrit. Liku shënon edhe fakte të tjera mbi këtë origjinë. Në një bisedë që ai pati me Petron vetë, më 1 korrik të viti 1805, kur anglezi vizitoi Sulin me të, si dhe me kryen e divanit (qeverisë) të Aliut, Mehmet efendinë, e me një kapedan të vezirit, Janaqin, kryearkitekti i ka folur për qytetin e tij të lindjes (*his native town*) dhe për «*të tjerët fqinjë të Voskopojës, (që) dikur kishin pesë-gjashtë mijë, shtëpi, por që emigrimet i zvogëluan në më pak se tetëqind*». Ky qytet i lindjes kush mund të jetë tjetër veçse Korça, prej së cilës Petroja ka marrë emrin? Liku na informon edhe se «*gjëri dhe familja e tij (e Petros) janë në Korçë, ku herë pas here, me favor të veçantë, atij i lejohet të qëndrojë për disa ditë*». Petroja është pra edhe familisht banues i qytetit të Korçës.

Posa që viset e dëmtuara nga emigrimet, si Voskopoja dhe Korça me krahinat e tyre, Petroja ia ka përmendur posaçërisht Likut, mund të mendohet që kryemjeshtri të ketë qenë nga ndonjë familje oparake e shpërngulur në Korçë në kohën e anarkisë së madhe feudale që pllakosi vendin në shek. XVIII, sidomos në kohën e prishjes së parë të Voskopojës më 1769, — ajo njohu prishje të reja më 1772 dhe 1789. Opari, fqinjë i Voskopojës, ka qenë i njohur për mjeshtrit e tij. Këto vlejné të

shikohen, se ndihmojnë për të formuluar një hipotezë mbi datëlindjen e kryemjeshtrit tonë. Mund të supozojmë që Petroja të ketë lindur në Korçë pas prishjes së parë të Voskopojës, pra aty nga fillimi i viteve 70 të shek. XVIII. Kjo datë nuk bie në kundërshtim me qënien e tij si kryearkitekt i Ali pashës më 1805, dhe që prej pesë vjetësh, si na dëshmon Liku dhe si do ta shohim edhe më poshtë. Sa për pronat e tij të Korçës, do besuar se, përveç shtëpisë, kryemjeshtri kishte edhe ndonjë copë tokë, gjë e nevojshme për atë kohë në qytetet tona me ekonomi gjysmë fshatare. Përndryshe, kryemjeshtri s'kish përse t'i fliste për gjërin e tij Likut. Sidoqoftë, këto janë vetëm hipoteza pune.

Dëshmia e Likut, sipas së cilës Petro Korçari ishte «*kryearkitekt*» i Ali pashë Tepelenës (*his chief architect*), vërtetohet edhe nga dëshmitë e Vodonkurit dhe Pukvilit. Ky i fundit e quan «*Mjeshtrë Petron*» «*Voban të tij*» (të Aliut, — *son Vauban*). Vobani, ushtarak i gradës më të lartë, mareshal, në shek. XVII-XVIII, bëri një punë të madhe për të përsosur mbrojtjen e qyteteve të Francës, si komisar i përgjithshëm për fortifikimet. Mos duhet të nxjerrim nga dëshmia e Pukvilit se Petro Korçari ishte vetëm kryearkitekti ushtarak i Ali pashës?


Liku sjell të dhëna që na sigurojnë se Petroja ishte kryearkitekt i vezirit për gjithë llojet e ndërtimeve. Ai shkruan se «*Petroja është (...) vazhdimisht i angazhuar në mbikqyrjen e ndërtimit të disa kështjellave, pallateve, për vezirin ose bijtë e tij*». Ai me Petron, atë ditë të korrikut 1805, për të cilën na ka folur, vajti pikërisht që të vizitonte Sulin, ku Ali pasha po ngrinte kalanë e malit Tripa. Ka qenë një kala me një saraj brenda dhe me ndër-

time të tjera civile, pra diçka ushtarake dhe civile në të njëjtën kohë. Sipas Likut gjithashtu, Petroja nuk kishte ndërtuar vetëm pallatin, por edhe një urë në Tepelenë, «dhe shumë pallate dhe kështjella të pashait». Nga ana e vet, Pukvili, duke folur për morinë e ndërtimeve të Petros, përmend edhe veprat e tij të vogla, «pirgjet» ose kullat.

Petro Korçari drejtonte pra gjithë ndërtimet e kërkuara nga Ali pasha, ushtarake e civile, të vogla e të mëdha, kështjella, pallate, ura, kulla, banesa garnizonesh etj, siç është e kuptueshme për një arkitekt mbikqyrës të përgjithshëm të ndërtimeve të një shteti. Po ndofta puna e tij peshonte më shumë në ndërtimet ushtarake, gjë e natyrshme në përpyekjet e Ali pashës.


Liku nuk na tregon vetëm funksionin e Petro Korçarit, si kryearkitekt: ai shton edhe se kryearkitekti ishte «një inxhinier» (*the Vezir's chief architect an engineer*). Këtë nuk na e thotë as Pukvili, as Vodonkuri, të cilët përkundrazi, duke e përçmuar punën e kryemjeshtrit shqiptar, lënë të dyshosh për aftësitë teknike të tij. Po ne preferojmë t'i përmbahemi dëshmisë së Likut, që është shumë më e plotë në krahasim me dëshmitë e të dy autorëve të tjerë. Dhe, duke pasur parasysh titullin inxhinier që ai i jep kryearkitektit Petro, ka arsye të hedhim mendimin se ky ishte njeri me studime të larta speciale, të cilat mundët t'i bënte atëherë vetëm në universitetet ose shkollat e Evropës.

Nga biseda e Likut me Petron, marrim vesh se, «duke gërmuar tokën për një saraj të ri në kështjellën e Janinës, u gjet një gur me emrin e Thoma Igumenosit, mirëbërës i Janinës». Guri dëshmonte për një ndërtim të moçëm që kishte ekzi-



Kastroja, — viz. (bot. Holland, 1815).


Kastroja, — rrënimet e saj, — foto e shek. XX
(bot. Rëmerand).






Litharici, me lagjen jashtë mureve të tij, — viz. Kokrell, 1813 (bot. Hjuż 1820).


Litharici, — salloni i pritjeve dhe i ceremonive, — Sipas një gravure të kohës (bot. Beresford, 1855).




Plani i Qoshkut,
sipas bot. Hjuz
1820.




Shtëpia ku banoi Bajroni në Janinë, — viz. Kokrell, 1813,
(bot. Hjuz; 1820).





Suli, — kështjella me pallatin etj. (bot. Holland, 1815).

Kështjella e Butrintit sot (foto Instituti i Monumenteve).



stuar në atë vend. Kur Petroja i tregoi vezirit për zbulimin, Aliu e ngarkoi kryemjeshtrin të vinte e të lexonte «gjithë historitë e vjetra», për t'i mësuar atij, të nesërmen në mëngjes, se «*monumenti i kujt*» ishte ai për të cilin fliste guri. Kjo tregon se Petroja ishte njeri me shkollë dhe i kishte disa mundësi, sikundër flet njëkohësisht edhe për interesat e gjera të kryezotit shqiptar.

Është pa dyshim inxhinieri që e informoi Likun, se «*ai mirëbërës i Janinës thuhet të ketë qenë një tiran shumë më i lig sesa Aliu vetë*», si shkruan dëshmitari. Të dhënat Petroja mund t'i gjente në kronikat mbi Janinën, që atëherë qarkullonin në dorëshkrim në kryeqytetin e Ali pashës. Dy prej tyre dimë se i shtiu në dorë Pukvili, që edhe i botoi në origjinal e të përkthyer frëngjisht. Një dorëshkrim të tillë përdori edhe Hjuzi për të përvijuar historinë e Janinës. Në këtë dorëshkrim flitej edhe për një «*despot të panjohur Thoma*», të cilin kronisti anonim e cilësonte «*një shpirt të errësirës e një bir të satanait*», i mbiquajtur «*alvanitokton*», që do të thotë greqisht «*vrasës i shqiptarëve*». Ai i kishte mbaruar ditët e tij të errta prej duarve të rojeve personale, në vitin 1385, vit kur turqit u dukën në afërsitë e Artës, po despoti Thoma nuk dëgjoji të vinte e të mbronte vendin kundër invadorëve.²⁸ Lexuesi që njeh historinë tonë të Mesjetës, e çon menjëherë mendjen te famëkeqi despot serb i Janinës, Thoma Preljuboviç, i cili sundoi pjesën e dytë të shek. XIV dhe ishte një pasardhës i të vjehrrit të tij të vendosur në Epir në kohën e pushtimeve të car Dushanit, në vitet 40 të atij shekulli. Në afërsitë e Artës, turqit i sollën despotët grekë, që orvateshin të rimerrnin vendin; por invadoret e rinj u



thyen nga fisnikët arbëreshë të kohës, dëshmon kronisti bizantin Kantakuzeni. Këta fisnikë ishin Gjijn Bua Shpata dhe Pjetër Losha me shokë, që kanë qenë gati përherë thikë e brisk me despotin Thoma.²⁹

Mund të supozohet fare mirë se inxhinier Petro Korçari, i lidhur me të diturit e Janinës dhe që njih-te kronikat e vendit, ishte njeri me studime.

Liku sjell të dhëna të tjera që mund të mbështetin edhe çka u tha më sipër. Petroja ushqente ndjenja të hapta antif feudale. Krahinat e vendlindjes së tij kishin pësuar keq nga anarkia feudale përpara se të stabilizonte aty pushtetin e vet dhe qetësinë Aliu i Tepelenës. Por Ali pasha, nga ana e tij, e nënshtroi në një shfrytëzim të rëndë popullsinë e fshatit e të qytetit. Ai shtiu në dorë pjesën më të madhe të tokave të punueshme të viseve mbi të cilat sundonte dhe ku arriti të zotëronte rreth 1000 çifligje. Angaritë rëndonin gjithashtu së tepërmi mbi popullsinë. Njerëzit që kishte nën shërbim, veziri i shfrytëzonte në mënyrat më të ndryshme, përpiquej të përfitonte sa më tepër nga puna e tyre dhe mundësisht të mos i shpërblente fare. Sipas bisedës së tij me Likun, Petro Korçari, që loste një rol aq të madh në forcimin ushtarak të shtetit të Ali pashës dhe në madhështimin e autokratit, kishte pesë vjet që i shërbente vezirit e nuk ishte paguar prej tij. Shembull tipik për sa thamë. Kryemjeshtri Petro kishte pra edhe arsye personale të forta për të qenë një antif feudal i bindur. Zoti i tij e trajtonte gati si një skllav, duke mos e lënë të shkonte në Korçë për të parë familjen, veçse rrallë. Liku thekson se kryemjeshtri e ndjente veten pranë Ali pashës shumë më keq se kapedan Janaqi.

Konj. 1. 1964
D. C. C. 1964

Liku na mëson gjithashtu, se gjendjen e rëndë të popullit, «*mjerimin e popullsisë kristiane*», Petro Korçari e shpjegonte jo vetëm me egërsinë e feudale, por edhe me jetën në luks, me «*ekstravagancën*» e klerit të lartë ortodoks. Kryemjeshtri vështronte drejt: ai e lidhte saktë shfrytëzimin feudal me shfrytëzimin e kishës.

Petro Korçari, kryemjeshër i kulturuar, që ushqente ndjenja të tilla, të lidhura me idetë e përparuarra të luftës së borgjezisë evropiane kundër feudalizmit e kundër shërbëtores së tij, kishës, ka arsye të ketë hyrë në ndikimin e këtyre ideve posaçërisht gjatë studimeve, që mund të besohet se ka bërë diku në ndonjë shkollë të Evropës, ku mori titullin e inxhinierit.

Po, siç u tha, Pukvili me Vodonkurin e kanë nënvleftësuar me sa mundën. Ndërsa i pari nuk e bën këtë drejtpërsëdrejti, por i përçmon atij shpesh veprat, duke përçmuar në përgjithësi ndërtimet e Ali pashës, i dyti shprehet haptazi. «*Fortifikimet (e vezirit), — shkruan ky, — ishin përgjithësisht të drejtura nga selihdari i tij*³⁰ *dhe nga një shqiptar me emër Petro, njëri kaq kokëshkëmb e injorant sa dhe tjetri*»³¹. Vetë fjalët që do të pasojnë, përsëri në gojën e Vodonkurit, zbulojnë se ky, si inxhinier ushtarak, pati mosmarrëveshje të shumta me kryezotin dhe njerëzit në shërbim të tij për ndërtimet, dhe shpjegojnë qëndrimin fyes të kolonelit të Napoleonit. Ai shkruan se «*asnjerit nga projektet që i paraqiteshin atij (Ali pashës) nga inxhinierët (francezë, — Dh. Sh.) që iu dërguan, nuk i jepej udhë*». Kryesori ndër ata inxhinierë ishte vetë Vodonkuri. Dhe ky, si shembull të keqe pune, jep pikërisht

«fortesën» (fort) e Prevezës dhe fortifikimet e Litharicit në Janinë, ku ai punoi vetë, sigurisht nën drejtimin e kryearkitektit shqiptar. Kështjellën e Prevezës, me ironi, ai e quan «të famshme» dhe e karakterizon si një fortifikatë të thjeshtë (a mean redoubt), e cila nuk do të kishte mundur të mbante kundër armikut «as dy orë»³².

Ky përcmim dhe puna, në fakt e dobët, e inxhinierëve ushtarakë të Napoleonit, ishin arsye të forta për ta hedhur Petron në mosmarrëveshtje të acaruara me ta. Vodonkuri me Pukvilin, në një mënyrë a në një tjetër, mohonin gjenium krijues të kryemjeshtrit shqiptar. Porse vetë admirimi, që përmedëm se po ata kanë shprehur më se një herë përndërtimet madhështore të kohës në zotërimet e tepelenasit, d.m.th. për ato ndërtime që drejtoi Petro Korçari, tregon se kritikak e tyre qenë të ekzagjeruara dhe dëshmon për keqdashje.

Cilat qenë vitet kur Petro Korçari shërbeu pranë Ali pashë Tepelenës si kryearkitekt?

Pohimi i Likut më 1805, se kryearkitekti inxhinier «me këtë zanat ka shërbyer pesë vjet» tek veziri, na siguron se Petroja ishte në shërbim të Aliut që më 1800-1. Sipas supozimit që u bë më lart, ai duket të ishte këtë kohë rreth 30 vjeç, pra në një moshë kur edhe studimet mund t'i kishte kryer, edhe përvojën ta kishte fituar, edhe emër të kishte arritur, që iu dha një besim, i cili s'kish se ku të ishte më i madh. Dëshmia e Vodonkurit, për punimet e vitit 1807 në Prevezë, na siguron se, e pakta gjer në këtë datë, kur ushtaraku francez u largua gjithashtu nga Shqipëria, Petro Korçari vazhdonte të ishte kryearkitekt i vezirit të Janinës.

Kur dhe përse Petro Korçari u largua nga shër-

bimi i vezirit? Të dhëna s'kemi. Po le të na lejohet të bëjmë një hipotezë.

Liku dëshmon se Petroja ishte ndërtues edhe i një ure në Tepelenë. Ura ishte në këmbë në vitin 1805. Po më 1806 ajo ishte e shembur, dhe duket se u shemb brenda dimrit 1805-6, sepse këtë dimër, në mars, Pukvili e kaloi aty Vjosën me trap³³. Për urën e Tepelenës mbi lumin Vjosë flet edhe Hobhauzi, i cili, më 1809, e gjeti të prishur, kur vizitoi vendin bashkë me romantikun e madh, Bajronin: prej urës kishte mbetur vetëm gjysma dhe «*Aliu më kot përpiquej ta riparonte*»³⁴. Hobhauzi tregon se Aliu kishte sjellë nga Stambolli një britanik të kthyer mysliman, specialist i njohur për ndërtimin e urave, dhe ishte këshilluar me të. Specialisti ia kishte bërë të pamundur qëndresën e urës, sepse vendi ishte i mbushur së tepërmi nga prurjet e lumit, tabani i shtratit të Vjosës nuk ishte pra i shëndoshë dhe vërshimet e vjeshtës nuk e linin urën në këmbë. Edhe më 1809, në Tepelenë lumi kalohej me trap.

Me që Ali pasha ftoi nga Stambolli një specialist të njohur për ura, mund të supozohet se më 1809 Petro Korçari nuk ishte më në shërbimin e tij. Hobhauzi nuk përmend as atë dhe as ndonjë tjetër arkitekt apo kryearkitekt shqiptar në shërbim të vezirit. Kështu nuk përmend as Hollandi, i cili kaloi nga Tepelena më 1812, dhe as Hjuzi, që e vizitoi vendin disa muaj pas tij. Hollandi dëshmon se ura kishte qenë shembur dy-tri herë, «*me gjithë përpjekjet e vezirit për ta bërë atë të qëndrueshme*». Herën e fundit, ajo u shemb më 1812.³⁵ Ali pasha ka marrë edhe opinionin e Hollandit për çështjen e urës së Tepelenës. Ai, tregon udhëtari, «*donte të ngrinte një monument shumë të qëndrue-*

shëm për vetveten në vendin e tij të lindjes». Tepelenasi i ka rrëfyer Hollandit që «shumë inxhinierë evropianë i kishin thënë se që i pamundur» ndërtimi i një ure në atë vend mbi Vjosë, porse Aliu i besonte «një shansi sukcesi»,³⁶ me gjithë pamundësitë teknike që paraqitnin specialistët.

U zgjatëm në këto dëshmi jo vetëm për Petro Korçarin, po që të tregojmë edhe një herë pasionin e madh të Aliut për ndërtimet dhe sesi i lidhte ai ato me madhështimin e vetvetes. Le të vemë re këmbënguljen e tij në vendimet që merrte dhe vullnetin për t'i realizuar ato, mospërfilljen e dështimeve.

Duhet besuar se Petro Korçari, në vitin 1812, kur Hollandi kaloi nga Tepelena dhe nuk ia përmend as ai emrin, nuk ishte më në shërbim të Ali pashës. Është koha kur, për ndërtimet civile, Aliu sjell nga Vjena Frejvaldin, të cilin u përpoq ta përdorte edhe për ndërtimet ushtarake. Më 1814, ai kishte si inxhinier kryesor Monteleonen. Pra këtë vit është fare e sigurtë se Petro Korçarin s'e ka më krye-arkitekt. Ndërtimi dhe shembja e tretë e urës së Tepelenës atë vit mos do lidhur me largimin e Petros nga Ali pasha?

Në dimrin 1805-6, kur ura u shemb së pari, Petroja vazhdonte të ishte në shërbim të tepelenasit. Ai provoi edhe një ose dy herë të tjera dhe ura nuk qëndroi. Në zëmërimet e veta të tmerrshme, pashai duket ta ketë dëbuar. Po ta kishte persekutuar ose vrarë, zor t'i kishte shpëtuar fakti një Pukvili. Ky erdhi si përfaqësues diplomatik në Shqipëri në shkurt 1806, kur Petroja ishte në shërbim të Aliut, dhe qëndroi gjer në dhjetor 1816. Pukvili nuk donte as Petron, si nuk donte të zotin e këtij, dhe zor t'i ki-

shte shpëtuar fundi tragjik i kryearkitektit, po të ketë pasur Petroja një fund të tillë.

Po edhe kjo mbetet një hipotezë; midis hipotezash të tjera që shtrëngohemi të bëjmë. E sigurtë duket të jetë se inxhinier Petro Korçari është larguar nga shërbimi i Ali pashë Tepelenës brenda viteve 1807-12, më shumë brenda viteve 1807-9, dhe nuk dimë t'i ketë shërbyer më vezirit. Se ku vajti dhe ku mbaroi, nuk kemi asnjë të dhënë. Më 1807, ai duket të ishte ende mjaft i ri, as 40 vjeç.

IV. NDËRTIMET E PETRO KORÇARIT SI KRYEARKITEKT I ALI PASHË TEPELENËS

Të dhënat direkte mbi ndërtimet që bëri inxhinier Petro Korçari, i kemi nga Liku. Të dhënat e tjera, të tërthorta, i qëmtuam në autorë të tjerë.

Ndërsa Liku përmend me emër tri-katër ndërtime të Petros, Pukvili, duke shënuar një numër këstjellash, pallatesh e ndërtimesh të ndryshme, që ai i pa në këmbë gjatë udhëtimeve në zotërimet e vezirit shqiptar e sidomos në rrethet e Janinës, të Artës e Prevezës, të Gjirokastrës, Delvinës, Përmetit etj, në vitet 1798-1801, po më shumë më 1806, na siguron për ndërtimin e tyre para këtyre datave. Ai na ndihmon kështu, pa dashje, që të zbulojmë se ç'është ndërtuar gjatë kohës kur Petro Korçari ishte kryearkitekt i tepelenasit. Edhe kur Pukvili jep emrin e ndonjë inxhinieri, që mbikqyrte punimet e këtij apo të atij ndërtimi, punimet duhen konsideruar se bëheshin nën drejtimin e kryearkitektit tonë. Ai autor, si dhe ndonjë tjetër, p.sh. Manzuri, qëllon të japë edhe ndonjë datë për ndërtimet që përmend.

* Liku thotë shprehimisht se Petroja nga Korça «ndërtoi sarajin në Tepelenë». Ai thotë gjithashtu se kryearkitekti kishte ndërtuar edhe urën në atë qytet. Korçari ishte duke mbaruar së ndërtuari në korrik 1805 një kala me rëndësi në Sul: «Kështjella në mes të malit Tripa, të cilën veziri filloi ta ndër-» *

tonte posa u bë zot i Sulit (është) pothuajse e mbaruar», shkruan Liku. Nga fjalët e këtij mund të kuptohet se Petroja ishte drejtpërdrejt arkitekt i asaj kalaje, projektues i saj (*the fortress in the middle of Mount Trypa, which... my companion Kyr Peter, of Korytza, is the architect*). Liku tregon edhe se Petros iu desh të bënte nivelime të terrenit për të ndërtuar kështjellën, dhe jep, me këtë rast, një detal të punës dhe të mundësive teknike të kryemjeshtrit. Nga ana tjetër, kemi edhe idenë e afateve shumë të shkurtra që impononte Ali pasha për ndërtimet e tij, gjë që duhet nënvizuar.

Një kështjellë e madhësisë mesatare, si ajo e Sulit, u ndërtuar gati për një mot e gjysmë, po të kemi parasysh se Ali pasha e pushtoi Sulin në dhjetor 1803. Pavarësisht mundësive jo të vogla që kishte veziri në njerëz dhe në materiale, prapë kjo është një kohë më se e shkurtër. Po, sikundër e kemi parë, Aliut nuk i priste koha që të zbatonte planet e çlirimit të tij të plotë.

Në kështjellën e Sulit, që mbrohej prej një kordonit muresh me bedena, Ali pasha bëri të ndërtohet edhe një saraj. Aty u ndërtauan banesa për garnizonin, si dhe një xhami³⁷. Këto ndërtesa nuk dimë nëse u ngritën paralelisht me kështjellën ose fill e menjëherë pas saj; veç duket se jo paralelisht, meqë Liku s'i përmend më 1805. Po le të kthehemi te kalaja dhe saraji i Tepelenës.

Bashkë me urën mbi Vjosë, ato ishin në këmbë në korrik 1805. Si vepra të Korçarit, ato nuk mund të kenë nisur të ngrihen³⁷ përpara viteve 1800-1, kur Petroja hyri në shërbim të Ali pashës. Pra u ndërtauan për një kohë prej jo më shumë se 4-5 vjetësh. Një volum i tillë ndërtimesh, një ansa-

mbël vërtet i madh arkitekturor, u krye, sikundër shihet, në një afat që sot mund të duket i pabesueshëm. Po le të kemi parasysh masën e njerëzve që punuan shpesh angari si në ndërtim, ashtu edhe në nxjerrjen dhe transportin e lëndës. Ali pasha nxitohej për të fortifikuar shtetin e tij, por ai nxitohej edhe që t'i jepte gjithë pamjen madhështimit të vetvetes.

Ata që e kanë vizituar pallatin e Tepelenës përpara se ky të digjej në janar 1819, d.m.th. ashtu si e kishte ngritur kryemjeshtri korçar dhe jo të ngritur prapë në tërë bukurinë që pati³⁸, tregojnë se ai kishte shoq, për madhësi e luks, vetëm sarajet e Janinës. Pukvili, që e vizitoi më 1806, e përshkruan shumë pjesërisht, sepse vetëm salloni i madh i pritjeve apo i ceremonive të vezirit dhe oda ku banoi miku ishin në gjendje; të tjerat ishin «duke u ripërtërirë sërish», kurse në bimëzat punohej akoma. Bimëzat destinoheshin për të ruajtur thesaret e kryezotit dhe kemi më se një dëshmi që ato ruheshin, në pjesën më të madhe, në Tepelenë. Që të «ripërtërihej», përbrenda pallati më 1806, kjo tregon që Aliu s'ka qenë i kënaqur me anën funksionale ose me zbukurimet e tij. Puna e nxituar e kish edhe këtë rrezik, për të cilin Pukvili vetëm sa aludon.

I njëjti autor flet edhe për shtëpitë e Tepele-nës që u përkisnin njerëzve të besuar të Aliut dhe që ky s'pushonte «së mbushuri me dhurata». Ato paraqiteshin të denja për kështjellën dhe pallatin që rrethonin. Ali pasha nuk kishte pra kujdes vetëm për kështjellën dhe pallatin e vet, por donte që edhe qyteti i vendlindjes së tij të merrte një pamje të pëlqyeshme.

Për sarajin e Tepelenës, Pukvili shkruan:

*Me Tepelenë
në janar*

«Pallati ku unë u gjenda, i ndërtuar në një plan të gjerë, paraqiste, midis koridoresh anësorë, një sallë të një përpjesëtimi tepër të madh, e rrethuar me minderllëqe të mbuluara me brokarde të Lionit dhe që mbahej prej kolonash të vendosura përreth një hauzi katror veshur me mermer të bardhë, nga mesi i të cilit ngriheshin shumë fiskaja uji»³⁹.

Ky përskrim, sado i shkurtër, na jep megjithatë një ide të madhështisë së ndërtimeve që bënte Petro Korçari, me vendosjen (pallati ishte «i vendosur në një pikë me një vështrim madhështor», shkruan Pukvili) dhe përpjesëtimet e tyre, me sallonet shumë të gjera të pritjeve dhe të ceremonive, me luksin e brendshëm.

Përskrimi që bën Hobhauzi, i cili e vizitoi Tepelenën më 1809 dhe kaloi edhe ndonjë ditë aty bashkë me Bajronin, nuk është më i gjatë. Hobhauzit i ka bërë përshtypje shtrirja e ndërtesës. Ai shënon edhe se Tepelena ishte një nga selitë më të preferuara të Ali pashës.⁴⁰ Në të vërtetë, ajo ishte më e preferuara, porse Aliu që i detyruar të qëndronte zakonisht në kryeqytetin e tij. Seli të tjera të preferuara ai ka pasur Prevezën, ku vinte shpesh⁴¹, si dhe një saraj në fshatin Karkalopullo, në afërsitë e Janinës⁴². Edhe aty, si do ta shohim, ishte dora e kryemjeshtrit Petro.

Në Janinë, Ali pashë Tepelena kishte jo një, por tri pallate të vetat dhe dy të djemve të tij, Myf-tarit e Veliut. Njëri nga ato pallate, ai i quajtur i Kastros (gr. kështjellë), kishte qenë ndërtuar me kohë nga sundimtarët e Janinës dhe mundet që Aliu i bëri përmirësime apo zgjerime, sepse aty banoi e pakta gjer më 1806⁴³ dhe i pëlqente të rrinte shpesh

edhe më vonë, pasi ndërtoi, përpara atij viti, pallatin e ri, i dyti nga radha e me emër shumë të njohur, Litharicin. Pallati i tretë ishte Qoshku, i cili vërtet ka qenë një si qoshk, por i madh e si një saraj më vete. Dy pallatet e tij të reja, ashtu si dhe i vjetri, ishin të ndërtuar mbi liqen, i vjetri nga ana e Veriut, të rinjtë nga ana e Jugut dhe mbi një siujdhesë, ku ishin edhe dy pallatet e Myftarit e të Veliut. Formohej kështu, përreth Litharicit, një ansambël arkitektural që u linte mbresa të forta vizituesve. Ai ansambël dominonte qytetin dhe liqenin, duke pasur për sfond malet e larta, Pindet. Është ansambli më i madh arkitektural që ndërtoi Petro Korçari dhe që mund t'ia kishte zili cilido arkitekt i pasionuar për punë.

Do të ndalemi posaçërisht në katër sarajet e reja të Janinës, sepse na japin një ide mjaft të plotë të punës së kryemjeshtrit shqiptar, si me përmasat e tyre, ashtu edhe me vlerat arkitekturore artistike. Për ato saraje flasin gjithë autorët e përmendur, të cilët kanë hyrë e kanë dalë në to, por edhe kanë kërkuar të informohen posaçërisht.

Më 1805, duke folur për ansamblin e ri mbi liqenin e Janinës, pamë se Liku shënonte diçka për germimet që iu desh të bënte aty Petroja. Kështu koha e fillimit të punimeve për Litharicin mund të vendoset në vitet 1800-1, kur Petroja hyri në shërbim të vezirit. Ky përfundim del edhe nga përshkrimi që i ka bërë Pukvili kështjellës së Janinës dhe pallatit të saj të vjetër, ashtu siç i pa ai më 1801.^{43a} Ansamblin e Litharicit Pukvili e gjeti të mbaruar në shkurt-mars 1806, kur kryekonsulli erdhi me detyrë në Janinë.⁴⁴ Po të kemi parasysh volumin kolosal të punimeve të pallateve, dy të Aliut e dy të djemve

të tij, dhe të mureve rrethues, po të kujtojmë se Aliu ndërtonte atë kohë edhe kompleksin e Tepelenës, kemi një ide edhe për mundësitë shumë të mëdha të vezirit për ndërtime. Edhe kjo punë u krye brenda jo më shumë se 4-5 vjetësh, edhe pse volumi ishte dy-tri herë më i madh se në Tepelenë.

Përpara se të përshkruajmë veprat, le të tregojmë se, në mbarim të viteve 30 të shekullit të kaluar, as njëzet vjet që nga prishja e Aliut, pallatet nuk ekzistonin më. Dijetari francez Ami Buë, që vizitoi atëherë Janinën, na tregon se nga pallatet e Ali pashës, edhe nga i vjetri, kishin mbetur vetëm disa shenja.

«Kështjella e lartë e Litharicit, që dominonte qytetin në Jug-perëndim, — shkruan më 1840 A. Buë, — i ka lënë vendin një kazermë në formën e një patkoi të çrregullt»; «nga ajo ndërtesë masive nuk ekziston veçse një kullë guri të latuar e me disa kate» «nga tërë anët s'duken veç rrënoja (. . .), një mur i lidhur, që i përkiste haremit të Ali pashës, dhe, pjesërisht, disa baterive»⁴⁵.

Ky përshkrim le të na japë një ide të fatit tragjik jo vetëm të tepelenasit, por edhe të kryearkitektit të tij, sepse duhia e luftës dhe e mërisë osmane që vazhdoi, pak gjë la në këmbë nga vepra e Petro Korçarit dhe gati asgjë nga komplekset apo ansambllet e mëdha që ai ndërtoi. Po këtë do ta shohim edhe më tej.

Ja se si e përshkruan Hjuzi Litharicin, siç ishte në ditët e fundit të dhjetorit 1812, kur udhëtari arri-ti në Janinë bashkë me disa zotërinj të shoqërisë së lartë angleze, të cilët, ai, si njohës i kulturës antike, — Hjuzi ka qenë profesor i universitetit të Kembri-

xhit⁴⁶, — i përcolli në Greqi dhe në viset tona të Jugut:

«Ne hymë në pallat përmes një si vestibuli, që shërben si strehim për një karrocë të madhe gjermane; dhe që aty, duke ngjitur një palë shkallë fort të ngushta guri, arritëm në pjesën e banuar të sarajit, që është në katin e parë. Pasi përshkuam një sallë të madhe, e cila ka të paktën njëqind e pesëdhjetë këmbë gjatësi (49 metra, — Dh. Sh.), dhe ku qëndrojnë oborrtarët (është fjala për sallonin e madh të pritjeve ose ceremonive, — Dh. Sh.), na futën në një sallon të bukur, të mobiluar mirë dhe të stolisur me një bollëk prarimesh (një sallon i veçantë, ku Aliu priste më në intimitet, — Dh. Sh.). Dyshe-meja ishte e mbuluar me një qilim shumë të madh Turqie, dhe jastëkët e divanit, prej kadifesë më të bukur të Qipros, ishin stolisur me thekë ari. Dritaret, me kanata të mëdha xhami, linin të dukej liqeni dhe malet që kufizojnë horizontin. Gjithë dekorimet e këtij pallati ishin madhështorë».⁴⁶

Udhëtarët e huaj janë ndalur pak, për fat të keq, në përshkrimin arkitektonik të ndërtesave, gati vetëm në kthinat ku ata kanë mundur të futen. Por edhe i ka shastisur luksi i brendshëm, sikundër shihet në përshkrimin e sipërm të mysafirrit nga Anglia.

Më tutje ky, duke na dhënë një pamje të «sarajit të madh të Litharicit, që është i Ali pashës dhe i të dy djemve të tij Myftar e Veli» (Hjuzi nuk ka dalluar se ansambli shumë i madh përbëhej prej disa pallatesh) ka gzykuar se ato ishin «të stilit më të mirë turk», dhe na informon se, nga jashtë, muret e tyre ishin «të pikturuar me ngjyrat më të shkëlqyeshme».⁴⁷

Këtë pamje të jashtme të pallateve na e kanë

dhënë më gjerë Pukvili⁴⁸, që, edhe ai, gjykon se ata janë «ndërtuar si gjithë veprat turke, po që kanë këtë të veçantë, se mbi to shihen afreska të ekzekutuara nga bojatisës armenë». Dhe autori vijon me një përshkrim gati të hollësishëm të afreskave, përmes një ironie, e cila bie në sy që te përcmimi i piktorëve armenë të tyre.

Kishte, mbi fasadën e hyrjes së pallatit të djalit të madh të Aliut, një afreskë që paraqiste Myftarin vetë midis oborrtarëve dhe tek varte një njeri, kurse mbi fasadën e pallatit të djalit tjetër, ishte figuruar një peizazh me kafshë, flamurë dhe gjyle topash, e midis tyre Veliu. Le të shënojmë, në parantezë, se dhoma ku prehej ky djalë i dytë i vezirit, të cilin e tregojnë njeri me interesa kulturore, kishte të pikturuar në tavan qiellin, me diellin, hënën, yjet, një kometë me bisht në flakë dhe shkrepimën që çante hapësirën. Merret me mend qesëndia me të cilën Pukvili gjen rastin të shprehet për gjithë këto. Porse ai ka mundur të vërejë se «*dhomat e Aliut ishin (...) me arabeska të një shije të mirë*».

Prapë, përfaqësuesi i Napoleonit, që mbahej për një njohës delikat, duke u ndikuar nga dekorimi dhe mobilimi i sarajeve, përfundon në një gjykim krejt nihilist e krejt të padrejtë, kur thotë se «*tërë ato ndërtesa, ashtu si dhe pallatet prej druri e balte midis të cilëve ato bëjnë pjesë, nuk e meritojnë aspak vëmendjen e udhëtarit, as nderin e një përshkrimi*». Është një nga shfryrjet e njohura të Pukvilit, me të cilat haset lexuesi i librave të tij dhe që e vënë shpesh në dyshim objektivitetin e autorit.


Le të ndalemi edhe pak mbi faktin se pallatet e Ali pashës, përgjithësisht, kanë qenë të pikturuar nga jashtë me afreska, në katet prej druri të tyre, katet

e sipërme. Mbi sarajin e katundit Muzhar, pranë lumit të Bisticës, kishte një peisazh të Stambollit⁴⁹, ashtu si mund ta shohim sot akoma në fasadën e xhamisë qendrore të Tiranës (atë të Ethem beut), të përfunduar së ndërtuari e pikturuari pikërisht në kohën e Aliut të Tepelenës, më 1819-23. Pra afreskat mbi fasadat e ndërtesave të një farë rëndësie ishin të zakonshme për kohën, disa herë me tema të përbashkëta, siç duket edhe të konsakruar, sipas shijes së feudalëve vendës të ndikuar nga shija orientale.

Zakonin e pikturimit të jashtëm të ndërtesave e gjejmë në Berat, p.sh. në ndonjë ndërtesë kulturi, apo në Gjirokastër, në disa shtëpi të pasurish. Atë zakon e gjejmë edhe në Veri, si në Tiranë e Krujë. Nuk dimë a ishte vendës ky zakon, apo i ardhur. Në ndërtesat e kultit bizantin, ai haset që herët në Shqipëri e kështu edhe në shek. XVIII, p.sh. në Pojan e në Voskopojë. Vërejtja e Pukvilit, sipas të cilit ndërtesat turke nuk pikturoheshin nga jashtë, është një keqinformim.


Sidoqoftë, pikturimet e ndikimit oriental të ndërtesave janë të shijes së pronarëve dhe porositësve, ato janë punë edhe autorësh të ardhur nga Lindja, dhe nuk i duhen atribuar shijes së kryearkitektit vendës Petro.⁵⁰


Mbi Qoshkun, pallatin tjetër dhe mjaft origjinal të Ali pashës në ansamblin e Litharicit, kemi një dëshmi të shkurtër të Hobhauzit, i cili e quan «pavijon» dhe që ai e njohu më 1809. Autori thotë se pavijoni kishte formën tetëkëndshe, me «*kthina të vogla në secilin kënd*», me dysHEME të mermertë dhe, në mes, një shatërvan mermeri, të stolisur anëve me topa të veckël, «*të një modeli të hijshëm, gjji-*



Kështjella e Vivarit të Butrintit sot (foto Instituti i Monumenteve).

Kështjella e Vivarit si ka qënë (skicë, Instituti i Monumenteve).






Kështjella e Porto Palermos sot (foto Instituti i Monumenteve).


Urë e kohës së Ali pashës Tepelenës.






Berati, — viz. Kokrell, 1913 (bot. Hjuz 1820).

Shtëpi banimi në Berat e shek. XVIII (Viz. Instituti i Monumenteve).





Gjirokastrër — kështjella dhe ujësjellësi, sipas Lir, 1848.
(bot. po ky).

Krujë, banesë e shek. XVIII (foto Instituti i Monumenteve).



thashtu prej mermeri», topat flaknin ujë në hauz, ndërsa një «*organo*», e fshehur aty, loste një farë melodie italiane. Hobhauzit i kanë thënë se pavijoni ishte vepër e një «*frëngu*» (Frank, — evropian), ndërsa stolisja ishte bërë nga robër francezë, besonte ai (sigurisht ata të vitit 1798)⁵¹.

Këto pohime nuk e venë në dyshim rolin e krye-arkitektit Petro në drejtimin e punimeve të Qoshkut. Nga ana tjetër, autori gabohet për çështjen e stolisjes së pallatit, sepse ky u ndërtua pas viteve 1800-1, d.m.th. në një kohë kur Ali pasha i kishte liruar robërit e tij francezë. Stolisja e Qoshkut duhet të jetë bërë nga ndonjë evropian i pajtuar prej Ali pashës në kohën kur ai kishte në shërbim edhe Petron si krye-arkitekt.

Rëndësi ka fakti se në shijet e Ali pashës ndikonte sadokudo edhe Përendimi.

Hjuzi nuk na tregon gjë për Qoshkun, po thotë vetëm se ai ishte midis një kopshti të madh, ku Aliu e kish zakon të pushonte⁵². Por ai ka pasur ide në e mirë të na japë një skicë plani të ndërtesës, skicë që e riprodhojmë në ilustrimet e këtij libri.

Kaq na duket mjaft për t'i dhënë lexuesit një ide mbi pallatet e Ali pashë Tepelenës, d.m.th. mbi madhështinë e punës së bërë nën drejtimin e inxhinier Petros. Ilustrimet do ta konkretizojnë këtë ide, sidomos vizatimet e gravurat e artistëve bashkëkohës që vizituan Shqipërinë.

Mbetet që të përmenden shkurt edhe pallatet e shtëpitë e tjera të veçanta që Aliu kishte ndërtuar për vete dhe për djemtë e tij, ato që i gjejmë të banuara në vitin 1806. Do të përmendim edhe ndërtimet e tjera që ai bënte. Kështu lexuesi do të ketë një ide më të plotë të gjerësisë së veprës së Petro Korçarit.

Një nga sarajet e Ali pashës është ai i fshatit Bonila, ngjitur me Janinën. Atë Pukvili e ka njohur gjatë udhëtimit të vitit 1801. Po ndërtesa ekzistonte më 1799, kur përreth saj po mbaronin së krijuari kopshtijet, të cilat formonin dy yje, sipas planit të inxhinierit francez Sharbonel, rob i Aliut.⁵³ Pra, pallati nuk duhet të jetë punë e Petro Korçarit. Kemi sidoqoftë dijeni për një kopësht «à la française» të hershëm të Ali pashës.

Fakti flet edhe një herë për shije më të gjera të tepelenasit, shije që dimë se i ka pasur edhe djali i tij i dytë, Veliu, por edhe ndonjë feudal tjetër i vendit, që sadokudo vështronte edhe nga Evropa. Pukvili dëshmon që më 1801, se Ali pasha «i ka sytë të hapur mbi gjithçka ngjët në Evropë; ai vë njerëz t'i përkthejnë gazetat (dhe) i pëlqen të jetë i rrethuar nga iluministët».^{53a}

Ndër sarajet e para të Aliut duhet të jenë edhe ata të Libohovës, ku banonte e motra, dhe të Konicës⁵⁴, që ai i shtiu në dorë që herët. Por edhe për këto nuk mund të thuhet domosdo se qenë punime të Petro Korçarit; ka shumë të ngjarë që të qenë më të vjetra. Në Konicë, Aliu ka mundësi të ketë gjetur një pallat e ta ketë përmirësuar.

Kemi përmendur pallatin e Prevëzës, që ishte ndër më të preferuarit e Aliut. Ai lartohej buzë detit dhe Hjuzi e quan «pallatin më të bukur» të tepelenasit. Ali pasha kishte përdorur për të mermerin e rrënojave të qytetit të lashtë Nikopolis aty ngjat⁵⁵. Pukvili, që pallatin e quan «të bukur pa masë», tregon se atë e dogji Veli pasha, djali i Aliut, kur u

tërhoq nga Preveza në kohën e luftës së vitit 1821⁵⁶. Ai u ndërtua pas viteve 1798-99, d.m.th. në kohën e Petro Korçarit.

Siç u përmend më lart, një nga sarajet e preferuar të Ali pashës, — kurdoherë ndër ata që i gjejmë në këmbë dhe të banuar më 1806, në kohën kur Petro Korçari është kryearkitekt i tij, — gjendej në fshatin Karkalopullo, pranë Janinës. Gjë të posaçme nuk dimë për të, po nuk duhet të ketë qenë i madh⁵⁷.

Saraji i Peramas, në bregun lindor të Janinës, dhe përballë pallateve të mëdha të siujdhesës, në përfundim, ishte sigurisht i vjetër, por u meremetua nga veziri. Atë Pukvili duket se e ka njohur që më 1801, dhe e vizitoi në shkurt 1806. Tani, pallati përdorej si burg e si vend izolimi⁵⁸.

Përfaqësuesi i Bonapartit pa ose vizitoi atë muaj edhe pallatin e vogël në fshatin Xixë, jo larg lumit Kallamas,⁵⁹ në Veri të Janinës, dhe një pallat të tillë në Murat të Dropullit⁶⁰.

Atë vit, ai i gjeti në mbarim e sipër punimet për kështjellën dhe pallatin e Përmetit, të cilin e quan «të bukur». Këtu punimet i mbikqyrte inxhinieri ka-labrez Kareto, për të cilin kemi folur. Pukvili ironizon me vetëkënaqësinë e tij për punën që po kryente⁶¹, duke harruar se atë punë e lëvdoi.

Ali pasha, sikundër kemi shënuar, zotëronte edhe një numër të mirë shtëpish pushimi, të cilat kishin paraqitjen e sarajeve të vogla dhe që i gjejmë të banuara në vitet 1806-9, sidomos në viset përreth Janinës, si në Muzhar⁶², në Xhegelovë⁶³, Stavraq⁶⁴, Zicë⁶⁵, Delvinaq⁶⁶, në Artë⁶⁷, Kaciko-Pazar pranë Artës⁶⁸, etj. Një shtëpi e tillë në Hundëcovë, në bregdetin himariot, ka qenë ndërtuar pas shkatërrimit të

këtij fshati dhe të Sh. Vasilit e Nivicës pranë, oç pu-
shtoi Ali pasha në pranverë të vitit 1798⁶⁹.

Le të shënojmë se e kohës së shtëpisë që për-
mendëm është edhe kalaja e Sh. Vasilit, një fortesë
e thjeshtë, jo kaq në gur sa në plithar e dru.⁷⁰ Po
ashtu edhe kalatë në gur të gdhendur të Porto Paler-
mos⁷¹ e të Butrintit⁷², vende mbi të cilat Aliu u bë
zot më 1798 dhe nxitoi t'i fortifikonte ose rifortifi-
konte (Butrintin). Ndofta Petroja drejtoi aty mbari-
min e punimeve, nëse këto zgjatën më shumë se dy
vjet. Sidoqoftë, ato kala Pukvili i gjeti të ndërtuara
më 1806 dhe i përshkuan.⁷³

Nuk po zgjatemi për ndërtesat e haneve⁷⁴, për
bankinat⁷⁵, çisternat⁷⁶, kanalet⁷⁷, rrugët⁷⁸, etj. Këto
të fundit nuk duket të ishin nën drejtimin e kryearki-
tektit që vezirit dhe vërtetohet se Ali pasha ka pa-
sur një herë një drejtues të veçantë për ndërtimin
e rrugëve⁷⁹.

Kujdesi që tregoi Ali pasha për këto lloj ndër-
timesh, flet për interesin e tij shumë të gjallë në
nxitjen e zhvillimit ekonomik të vendit.

Aliut iu desh të meremetonte dhe të ndërtonte
një numër të madh urash. Një shembull: në rrugën
prej Janine në Strugë (ajo kalonte, ndër qendra të
tjera, edhe nga Leskoviku, Kolonja dhe Korça), Puk-
vili, që udhëtoi andej, shënon se kishte 28 ura⁸⁰. Ky
autor ka fjalë të mira për urat, të cilat i quan ndër-
time solide. Ka shumë mundësi që ndërtimi i tyre
të jetë bërë nën drejtimin e kryearkitektit, po ne
nuk dimë të përmendim me emër disa prej urave që
u ngritën në kohën e Petro Korçarit, përveç urës
së madhe të Tepelenës mbi Vjosë, për të cilën bi-
seduam më sipër.

V. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PUNËN E KRYEARKITEKTIT INXHINIER PETRO KORÇARI

Në këtë kapitull do të bëhet një provë vlerësi-
mi e punës së Petro Korçarit. Do të flitet për anën
e jashtme dhe për atë funksionale, për stilin, zbu-
kurimet, si dhe për qëndrueshmërinë e ndërtimeve të
bëra nën drejtimin e tij. Këto, shumë shkurt e në
mënyrë të përgjithshme. Sigurisht, për të dhënë një
ide sadopak të plotë mbi çështjet e sipërme, duhet
jo vetëm një hetim më i gjerë i letërsisë bashkëko-
hëse të Ali pashë Tepelenës dhe i dokumentimit të
mundshëm arkival, po sidomos studime komplekse,
në bazë hetimesh në vend, në një numër të madh
objektsh e gjurma objektsh, për të cilat studimet
ndër ne sapo kanë filluar⁸¹.

Ndërtimet e bëra prej kryearkitektit Petro Kor-
çari venë, sikundër u pa, që nga fortifikatat e thje-
shta dhe fare të vogla, e gjer te ansamblet arkitektu-
rore, të cilat, duke përjashtuar ato të kryeqytetit të
perandorisë osmane, Stambollit, ishin ndër më të
mëdhatë në Ballkan, aq sa t'u bënin përshtypje të
thellë të huajve që vinin prej visesh ku arkitektura
paraqiste shembulla nga më të shquarat, që nga Mes-
jeta dhe pastaj Rilindja evropiane e këndeje.

Vetë Pukvili, kur gjendet përpara kompleksit
arkitekturor të ndërtuar nga Petro Korçari në Te-
pelenë, admiron «shkëlqimin» dhe përmasat e tij.
Ai lëvdon edhe «elegancën e rrallë» të pavijoneve

buzë liqenit të Janinës, ku më se një qoshk stoliste vendin. Kur flet për kryeqytetin e vezirit tepelenas, Pukvili shënon se Janinën ai «*po e zbukuron*» me ndërtime «*shumë të gjera*»⁸². Tërë këto pohime që ai bën më 1826 në favor të ndërtimeve të Ali pashës, janë lëvdata direkte për punën dhe talentin e krye-arkitektit shqiptar të tij. Veçse është po ai i dërguar kontradiktor i Bonapartit, që ishte shprehur ndryshe gjashtë vjet më parë, më 1820, për ansamblin më të madh arkitekturor të ndërtuar nga Petro Korçari, Litharicin. Pukvili shkruante atë kohë si për ndërtime «*druri dhe balte, (të cilat) nuk meritonin aspak vëmendjen e udhëtarit, as nderin e një përshkrimi*», ai që u bëri, në fakt, «*nderin*» t'i përshkruante më shumë se shumë të tjerë!

Nuk vepron ndryshe Ibrahim Manzuri, i cili nga njëra anë, flet për «*pallatet madhështorë të Aliut e të dy djemve të tij*»⁸³, kurse, nga ana tjetër, nuk lë përçmim pa shprehur kundër tyre, duke arritur gjer atje, sa të përbuzë edhe bukuritë natyrore të vendit që ato i mban.⁸⁴

Si u tha edhe më lart, ndryshe kanë vepruar të tjerë, ndonëse, midis tyre, s'kanë munguar edhe gjykimet kritike. Hobhauzi, profesori Hjuz, kanë qëndruar me admirim të veçantë përpara ndërtesave, komplekseve dhe ansambleve arkitekturore që pati ngritur në Prevezë, Janinë, Tepelenë e gjetiu Petro Korçari. Hjuzi mbetet i impresionuar fort kur del në bregdetin e Jonit dhe shkel në Prevezë. «*Më 27 dhjetor (1812), — shkruan ai, — ne nuk vonuam të diktojmë sarajin madhështor të Prevezës*»⁸⁵. Kur arrin së pari në Janinë ato ditë, ai shpreh admirimin për «*pallatet madhështorë të Ali pashës*»⁸⁶, dhe kryeqyteti, sipas tij, ka «*një pamje të shquar*»⁸⁷. Këtë pamje Ja-

ninës ia jepnin, në radhë të parë, të katër pallatet e ansamblit të madh të Litharicit, që ndërtoi Petro Korçari.

Hobhauzi pëlqente jo vetëm pallatet e vezirit, por edhe godinat qytetare të Janinës, të cilat ai i ka përkruar me dëshirë, «si të gjera e të mirëndërtuara», me porta të mëdha e me oborre, midis limonash e portokajsh, me çardhaqe (*open gallery*), që kanë përrreth odat e familjes me dritare të vogla. Ato janë komode⁸⁸. Udhëtari anglez e ka gjetur «*shumë konfortabël*» dhe e ka pëlqyer mjaft edhe pallatin e vogël të Artës⁸⁹.

Përkrimet që i bëjnë ndonjë shtëpie private të Janinës të dy autorët e sipërm⁹⁰, kanë interes të veçantë për elementet e tyre kryesore, — portat, katet, shkallët e gurta, çardhaku, oda përrreth këtij, oda e miqve, dritaret e vogla, — elemente që të kujtojnë arkitekturën shqiptare të qytetit në shek. XVIII-XIX, atë të shtëpive shkodrane apo kruetane, të shtëpive të ndryshme të Goricës së Beratit, si dhe të shtëpive të Gjirokastrës.

U ndalëm në këto, sepse ndihmojnë për të vënë në pah karakterin e arkitekturës së qyteteve mbi të cilat sundonte veziri tepelenas dhe ku një rol të rëndësishëm kanë luajtur mjeshtrit shqiptarë. Aty, një kryemjeshër, si inxhinier Petro Korçari, luajti rol në ndërtimin e disa modeleve të asaj arkitekture në dhjetëvjeçarin e parë të shek. XIX. Çka thamë flet për unitetin e arkitekturës shqiptare në tërë zonat, konkretisht edhe në hapësirën ku sundoi gjatë tre dhjetëvjeçarëve Aliu i Tepelenës, tre dhjetëvjeçarë ndërtimesh të panumërta që ai bëri. I shënuam veçanërisht pastaj ato elemente, sepse kanë qenë tipike të vetë pallateve dhe banesave të tjera që u ngritën

nën drejtimin e Petro Korçarit, po për të cilat nuk kemi shumë dëshmi direkte.

Kështu, duke folur për Litharicin, Hjuzi i përshkruan shkallët e gurta, nëpër të cilat ai u ngjit në katin e parë, si «fort të ngushta»⁹¹, ashtu siç i kanë zakonisht shtëpitë shqiptare shkallët e tyre, si domos të brendshmet. Ali pasha, për pallatin e tij të madh, s'kishte kërkuar shkallë madhështore, si do të kishte bërë ndonjë princ i Perëndimit, por edhe i Lindjes. Janë shkallët me harqe, ashtu siç i shohim sot në kaq banesa të moçme të Shqipërisë së Veriut dhe të Jugut.⁹² Thjeshtësia e tyre s'kishte si të mos i binte në sy anglezit. Porse, një t'u ngjitur në katin e parë, njeriu gjendej shpejt në sallonin e pritjeve dhe të ceremonive, që na kujton, sigurisht në përpjesëtime shumë më të vogla, dhomat e miqve të shtëpive tradicionale shqiptare, dhoma ku ngjitesh përmyet shkallësh të veçanta.

U përmend më lart se si Ali pasha e priti profesorin e Kembrixhit me gjithë shokët e tij në një sallon më intim e më të vogël, por që prapë kaq i vogël s'qe, sepse e kishte qilimin fort të madh, shënon Hjuzi. Dhoma kishte një oxhak mbushur me goxha kërcunj që digjeshin, përveç mobilimit, që mikut të huaj i bëri përshtypje, dhe kanatave të mëdha prej xhami. Kjo s'duhet të ketë qenë «dhoma shqiptarçe», për të cilën flet gjetiu autori, po një tjetër dhomë e ngjashme.

Ajo dhomë shqiptarçe «ishte një kthinë katrore e madhësisë mesatare, muret e tymosura të së cilës janë të mbuluar me armë të çdo lloji, disa aq shumë të pasuruara me brilante, sa të merren vërtet sytë nga ndriçimi i tyre. Në qendër është një oxhak i madh katër faqesh, që ka formën e një shty-

lle të mbajtur nga disa harqe. Divani është i mbuluar me mindere stofash krejt të zakonshme, e dhoma s'ka stoli të tjera veç armëve»⁹⁷.

Ja ambienti më intim, ambienti krejtësisht vendës, i krijuar nga arkitekti shqiptar dhe ku Aliu e gjente veten sigurisht më mirë se në luksin me të cilin ai i ngarkonte sallonet, ku edhe shpaloste pasuritë e tij. Funksionaliteti i pallateve ishte parë kështu nga më se një anë, si për të paraqitur kryezotin në mënyrën dhe luksin pak a shumë oriental, sipas shijeve të pashallarëve të mëdhenj, si për të siguruar intimitetin, ku tepelenasit «i gjente rehat shpirti», sipas shijes së vendit.

Nuk po ndalemi më në panoramat e rralla që të gëzonte syri nga pallatet e ndërtuar prej kryearkitekt Korçarit. Këtë e ka theksuar çdo vizitues i tyre. Sigurisht, merita për zgjedhjen e vendit i ka përkatur në radhë të parë vetë porositësit. Po merita e kryemjeshtrit është se ai ka ditur ta shfrytëzonte vendin dhe të gjente zgjidhjet më të mira për hapësirat e dritës. Këto hapësira drite ishin veçanërisht të mëdha në pallatin e Qoshkut, ku çilesin nga të tetë anët e oktagonalit, nga të katër pikat e katër nënpikat e horizontit. Qoshku ishte si një belveder rrotullor përmbi Janinë, i kthyer nga tërë panoramat rrethuese: liqeni, malet, fusha.

Anën funksionale të pallateve të Ali pashës e njohim pak. Vizituesit kanë folur vetëm për sallonet kryesorë dhe ndonjë kthinë më intime të Aliut, ata kanë lëvduar ndonjëherë kthinat tek kanë qenë strehuar vetë, siç bën Hobhauzi për odën e Litharicit, ku banoi bashkë me Bajronin⁹⁴. Për dhomat e tjera, që s'kanë mundur t'i vizitojnë, njëra palë, me subjektivizmin keqdashës, i quan «depo», ku Ali pasha

vendoste plaçkën dhe gjithëfarë pasurish të tundshme që ai stivoste; pala tjetër, kur nuk përsërit pak a shumë ato që kanë shkruar të parët, ndalet në ndonjë nga dhomat e veçanta, ku pati rastin të hynte, si, p.sh., dhoma e trofeve (flamuj etj).

Ali pasha, si gjithë bejlerët shqiptarë të kohës, e ka kërkuar luksin oriental. Vodonkuri vë re se shijet përzjehen, kur flet për «*bashkimin e madhështisë më të shkëlqyer me shijen e keqe*»⁹⁵. Po kjo vërejtje, e cila i drejtohet kryesisht luksit të pashës dhe zbu-kurimit të pallateve të tij, nuk cënon domosdo edhe anën arkitektonike të ndërtimeve të bëra nga Petro Korçari.

Pallatet dhe shtëpitë e ndërtuara nga Petroja për Ali pashën e kishin katin përdhesës prej guri. Ai kat nuk ishte i banuar, në mos pjesërisht prej gardës. Në të ishin stallat e kuajve, vendet e strehimit të karrocave etj, si edhe tek shtëpitë e qytetarëve të kamur. Kati i parë ishte prej druri dhe banohej prej pashait vetë, prej oborrtarëve të tij më të afërt, miqve të dalluar dhe oficerëve të gardës. Ky kat paraqitej vërtet masiv, sepse, nga të katër anët, e kalonte gjerësinë e katit përdhesës, kishte koridore anësorë me xhamllëqe, apo qoshqe të veçanta për kthinat e ndryshme, me dritare të shumta, pa munguar edhe çardhaqet e haptë.

Le të përfytyrojmë, në përmasa të tjera, xhamllëqet e shumtë të shtëpive të Mangalemit në Berat, me përdhesën e gurtë dhe me katin e parë të drunj-të. Kati i sipërm i Litharicit, shkruan Pukvili, «*du-kej sikur dilte nga gjiri i një fortese që përbënte përdhesën e tij*». Lartësia e katit përdhesës ishte më e madhe se ajo e katit të sipërm dhe le të bëhet krahasimi me shtëpitë e Gjirokastrës e me shtëpi të vi-

seve të tjera të Shqipërisë, gjer në Veri, në ato raste kur pallatet merrnin formën e kullave, si shihet në ndonjë gravurë të kohës.

Me sa duket, ndonjë nga pallatet e mëdha kishte më se një kat mbi përdhësën. Në këtë rast, vetëm kati më i sipërm duket se ishte prej druri e çatmaje, kurse të tjerët prej guri të latuar. Madhështia e paraqitjes kështu fitonte shumë. A. Buë flet për një kullë që kishte mbetur nga Litharici dhe që, siç e pamë më lart, ishte prej «*disa katesh*» dhe prej «*guri të latuar*».

Krahasimi që u përpoqëm të bëjmë sadopak me ndërtimet shqiptare të shek. XVIII-XIX të disa qyteteve tona, na jep një ide mbi karakteristikat e arkitekturës së kryemjeshtrit Petro nga Korça, i cili ishte vërtet një arkitekt tipikisht vendës, pavarësisht huazimeve të pashmangshme që ka pasur midis arkitekturës orientale dhe arkitekturave të popujve ballkanas, pra dhe të asaj shqiptare, gjatë periudhës katër herë shekullore të sundimit osman. Shatrivanët, p.sh., në brendësi të salloneve e të disa odave të mëdha, janë elemente të ndikimit oriental.

Po, siç është treguar më sipër, ndikimi i Lindjes binte më shumë në sy në motivet e pikturimit të jashtëm e të brendshëm, si dhe në mobilimin e ndërtesave. Dhe ai dekor e luks bënte, le ta përsëritim, që vizituesit perëndimorë të tërhiqeshin shumë e të shastiseshin, aq sa të mos dallonin dot stilet.

*

*

*

Le të shohim së fundi shkurt se ç'ishte cilësia e ndërtimeve, për sa i takon qëndrueshmërisë së tyre.

U vu re se bashkëkohësit e huaj e kanë theksuar më se një herë «*brishtësinë*» e ndërtimeve, sikundër shprehet Hjuzi. Autori flet si për «*fragjilitetin e materialeve*» ashtu edhe për «*fragjilitetin e krahut të punës*»⁹⁶, duke dashur të thotë se edhe ndërtuesit qenë të dobët. Vërejtja është e rëndësishme. Profesori shkon gjer atje sa të shkruajë për «*pallatet e shkëlqyer, po pa asnjë elegancë (!)*» të Ali pashës, se janë «*të destinuar që të mos jetojnë më shumë nga i zoti i tyre*»⁹⁷. Ai bije kështu edhe në gjurmat e përçmuesve të arkitekturës sonë, duke rënë në kontraktë me vetveten.

S'është nevoja të zgjatemi edhe një herë për ngutim me të cilin ndërtonte Aliu, si për ta fortifikuar vendin nga të katër anët, si për t'i dhënë pamjen më të ndritshme vetvetes, familjes dhe oborrit të tij. Po një ngut i tillë, pa tjetër, ka shkaktuar që ndërtimet të mos ishin pa dobësi, të cilat autorët e ndryshëm i kanë vënë në dukje, sado me teprime. Nuk duhet harruar edhe se Aliu, që i çmonte perëndimorët për teknikën e tyre, veçanërisht ushtarake, ka rënë jo një herë e dy, po disaherë, në njerëz të paaftë e në sharlatanë, dhe se kjo i ka kushtuar.

Për të shfajësuar veten dhe inxhinierët bashk-atdhetarë të tij, Vodonkuri ua vë fajin ndërhyrjeve pa vend të Ali pashës në punën e tyre dhe kopracinë së tij.

Që Aliu ndërhyntë tepër e pa vend në punën e inxhinierëve dhe të arkitektëve të tij, kjo nuk lidhet vetëm me pasionin e madh për ndërtimet dhe me nevojat e mëdha e të ngutshme që ai kishte për të ndërtuar, por edhe me mosbesimin që krijoi me të drejtë ndaj arkitektëve dhe inxhinierëve, në radhë të parë të huaj. Kështu kuptohet sesi pashai e harxhonte një

pjesë të mirë të kohës nëpër kantiere. Doemos ai bëhej, në atë mënyrë edhe i bezdisshëm dhe kontrolli i tij i vazhdueshëm ndillte frikën; doemos, nga mosbesimi, ai mund që bënte edhe ndërhyrje pa vend. Po kryesorja është që Aliu i rrinte punës përsipër, që puna të vuante sa më pak nga moskujdesjet e sabotimet. Dhe kjo tregon edhe se ai i donte ndërtesat të forta. Tepelenasi, përmes tyre, kërkoi të përjetësonte lavdinë e vet në shekuj.

Që Ali pasha ishte koprac, kjo mund të ketë qenë e vërtetë për ndonjë fushë të veprimtarisë së tij, po për ndërtimet jo. Ai aty pati një veprimtari të pamasë, e cila kërkoi gjithashtu shpenzime pa fund, pavarësisht se kryefeudali i shfrytëzonte njerëzit gjer në palcë, i bënte të punojnë edhe pa shpërblim, fare, i mobilizonte si desh e kur desh, sa të desh, për gjithë angaritë. Për këtë, Manzuri ka folur gjatë dhe i duhet besuar⁹⁸.

Duhet thënë se, pa angaritë masive, pashai do të kishte mundur të bënte vetëm një pjesë të vogël të ndërtimeve që dimë se arriti të bënte, kurse, po t'i kishte shpërblyer njerëzit për gjithë ato ndërtime, shfrytëzuesit zor t'i kishte dalë buxheti i atyre 30 viteve që ai sundoi e përditë ndërtoi.

Këto ishin disa arsye të dobësisë së ndërtimeve të Ali pashë Tepelenës. Po janë edhe dobësitë e materialeve.

✧ Ndërtimet dhe rindërtimet ushtarake të Aliut nuk bëheshin me plithar e me lëndë druri, ashtu siç rrëmbehet Pukvili. Ata pak shembuj që na kanë tepruar në Shqipëri, si kështjella e madhe e Gjirokastrës (rindërtim shumë i zgjeruar dhe më i vonë se periudha e qëndrimit të Petros si kryearkitekt në Janinë), apo fortesat e Butrintit e të Porto Palermos,

muret e Tepelenës⁹⁹, dëshmojnë se ai i bënte ndër-
timet vërtet të qëndrueshme dhe me gur të latuar.
Dhe në se ka lejuar që të ngrihen edhe kala të dobta
(bie fjala, në Sh. Vasil të Bregdetit), ky s'ka qenë
rregulli; aty Aliun e ka shtyrë nevoja, ose aq e ka
vlerësuar ai strategjikisht vendin. Tepelenasi ishte
një strateg e me fortifikimet u muar gjatë në jetën e
tij prej ushtaraku; ai dinte ta çmonte qëndrueshmë-
rinë e tyre.

Pukvili me shokë kanë lënë të kuptohet se veziri
i Janinës nuk bënte fortifikime në lartësinë e artit
ushtarak të kohës, kur përdorimi i artilerisë i rrezi-
koi shumë fortesat e tipit mesjetar. Kjo meriton të
studiohet, se është fjala për një ndeshje konceptesh.
Sidoqoftë, është fakt se Ali pasha e kuptoi nevojën
e pajisjes të ushtrisë së tij me armët moderne dhe
kështjellat e fortifikimet e tij ishin të pajisura me
artilери. Por edhe transformime të mëdha ai nuk arri-
ti të bënte në atë drejtim. Rreziku i madh i tepele-
nasit, në veprimet e tij separatiste dhe për pavarësi
të plotë, i vinte nga ushtria turke dhe jo nga ndonjë
armik tjetër. Prapë, ajo nuk qëndronte në kushedi
se çfarë lartësie, edhe në armatime, në krahasim me
ushtrinë e tij, kurse shqiptarët që përbënin forcat e
armatosura të tepelenasit, çmoheshin si më të mirët
luftëtarë në gjithë perandorinë dhe ishin ngado me
emër. Nga kjo anë, Aliu mund që ra në një farë ve-
tëkënaqësie dhe nuk bëri sa duhet për t'u forcuar
e pajisur.

Materiali i dobët që përdorte në masë Ali pasha
për ndërtimet, që lënda e drurit. Po në ndërtimet
ushtarake, druri shërbente kryesisht për sistemimin
e brendshëm të tyre dhe për godinat e garnizoneve.
Ai përdorej shumë në katet e sipërme të sarajeve dhe

shtëpive, dhe, nga kjo anë, mund të pranojmë vërejtjen e Vodonkurit, se do të mjaftonte një shkrepse e vetme për t'u djegur. Litharici,¹⁰⁰ apo t'i be-sojmë Manzurit, se pallati i Tepelenës, më 1819, u dogj për shkak të rrufesë¹⁰¹. Këtë rrezik çatmaja e kishte.

Gjithë sa u tha mbi ndërtimet në kohën e Aliut të Tepelenës nuk vë sidoqoftë në dyshim, ashtu siç e kanë tepruar disa autorë të huaj, qëndrueshmërinë e veprave që ka drejtuar e ngritur kryearkitekti i vezirit, inxhinier Petro Korçari, në dekadën e parë të shek. XIX. Ndërtesa të shumta, sigurisht jo më të forta se ato, por edhe më të dobta, i qëndruan kohës dhe kanë arritur mirë gjer më sot. Rrënimi i madh, ndërtimeve të Ali pashës nuk u erdhi kaq shumë prej një dobësie inherente, sa nga furia osmane gjatë luftës së viteve 1820-22, nga shpërdorimet që bënë mbi ato ndërtime njerëzit të cilëve u ranë pa-staj në dorë, nga mosmirëmbajtja, nga rrënime të vazhdueshme që shkakttoheshin për një arsye e për një tjetër. I njohur është shkatërrimi i kaq kështjellave tona prej bejlerbeut të Rumelisë, pas masakrës që ai organizoi më 1830 në Manastir mbi parinë shqip-tare të Jugut.

Po gjithë sa u tha më lart nuk vë sidomos në dyshim vlerat estetike dhe funksionale të veprave të Petro Korçarit. Për këtë çështje, dëshmitë janë përgjithësisht pozitive. Autorët kontradiktorë tregojnë subjektivizmin e tyre, që shpjegohet me shijet, por edhe me mosmarrëveshtjet që disa prej tyre kanë pasur me Ali pashën, për arsye politike, ushtarake etj.


Për sa i përket autoktonisë së veprave të Petro Korçarit, ajo as që mund të vihet në dyshim.

VI. PËRMBYLLJE

Arti shqiptar ka, në kapërcyell midis shekujve XVIII e XIX, një arkitekt me vlerë jo të zakonshme, inxhinier Petro Korçarin, për të cilin s'kemi ditur asgjë. Këtu u përpoqëm t'i skicojmë jetën e t'i paraqitim e çmojnë veprën.

Petro Korçari ishte kryearkitekt i Ali pashë Tepelenës rreth viteve 1800-7, ndofta gjer më 1809-12. Ai mundet që ishte me origjinë nga Opari, njëra prej krahinave më të njohura të Shqipërisë e të Ballkanit për mjeshtër të ndërtimeve. Petroja muratorinë e kishte si të thuash në gjak. Njeri me kulturë, ai mund të supozohet që të ketë bërë edhe studime, në ndonjë qendër universitare të Evropës, posa i thonë inxhinier. Antifeudal e antiklerikal, kryemjeshtri ishte i lidhur me idetë progresiste të borgjezisë së kohës, që e shembi feudalizmin në Francë në vitin 1789.

Inxhinier Petroja nuk punoi gjatë pranë Aliut të Tepelenës. Po, për as dhjetë vjet, ose për diçka më shumë, ai ndërtoi një numër pa fund objektesh të mëdha e të vogla, ushtarake e civile, që nga një kështjellë si ajo e Tepelenës, me një pallat madhështor brenda, që nga ansambli i madh arkitekturor i Litharicit në Janinë, gjer te ndonjë pargj i vogël më ndonjë majë të Sulit apo mbi kanalim e Butrintit. U muar me të gjitha llojet e ndërtimeve, edhe me ura, edhe me objekte të kultit, edhe me hane. Ali pasha pati një oreks vigan për ndërtime, Petro Kor-




Gjirokaštër, — banesë e fillimit të shek XIX
(foto Instituti Monumenteve).



Shkodër, — banesë, e shek. XIX, (foto Instituti i Monumenteve).

Hasi i thatë (Veri), — banesë e shek. XIX (foto Instituti i Monumenteve).



çari iu përgjigj atij oreksi me një veprimtari vërtet vigane. Dhjetëvjetshi gjatë të cilit ai ishte kryearkitekt ka qenë periudha më e dëndur e ndërtimeve të Aliut, që tani e kishte konsoliduar mirë pushtetin e tij politik, dhe i kishte rritur shumë mundësitë ekonomike dhe financiare. Ajo ka qenë koha kur ai ngriti objektet e tij më të mëdha ushtarake dhe civile. Pukvili, që u përpoq ta përçmonte punën e mjeshtër Petros, u shpreh nga ana tjetër drejt, kur e quajti «Voban» të vezirit të Janinës, dhe nuk e teproi kur tha se, ky Voban «ka ndërtuar më shumë pirgje në Epir, sa nuk rrëzoi Pal Emili qytete».¹⁰² Ne mund të thoshim edhe më saktë, se Petro Korçari ndërtoi më shumë fortesa e pallate sa rrëzoi qytete famëkeqi romak. Ai qe një ndërtues i një veprimtarie të tillë, që mund të jepet si shembull i rrallë në historinë e përgjithshme të artit shqiptar. Dhe duhet theksuar se ne nuk njohim më shumë sa 7-8, e tepërmja 10-12 vjet të punës së kryemjeshtrit.

Sigurisht, merret me mend se, në çastin që ai është larguar nga shërbimi i Ali pashë Tepelenës, kryemjeshtri s'ka mundur të sigurojë më një terren të tillë gati të pamatur veprimtarie krijuese. Kjo për të ka qenë një fatkeqësi e madhe shumë. Kjo, pa dyshim, ka qenë një fatkeqësi jo e vogël edhe për Ali pashën vetë, sepse një kryearkitekt të aftësive të Petro Korçarit ai s'ka pasur mundësi ta gjente lehtë. Atij, me sa duket, ia zuri vendin një i huaj i paaftë, Monteleoneja.

Inxhinier Petroja luftoi kundër gjithë vështirësive. Luftën më të madhe ai e bëri me sahatin: afatet e ndërtimeve që ai duhej të kryente, nuk ka sesi të qenë më të kursyera. Koha qe një koprace e madhe për Petron, po kryemjeshtri, nuk iu bind, — koha iu

bind atij. Ai duhej të kryente punime që bëheshin me forcë angari, pa harruar mëditësit, d.m.th. përmes tërë bishtënimeve të mundshme të njerëzve që detyrohen të punojnë si skllëvër e pa shpërblim, ose të shpërblyer keq. Por edhe mjeshtërit e zot që mobilizonte kryefeudali dhe që shpesh nuk i paguante, mos do të bishtëmonin pak? Të drejtoje tërë atë veprimtari ndërtuese që kishte pushtuar sundimet e hapura të Ali pashë Tepelenës, dhe në ato kushte, kjo ka qenë një vështirësi tepër e madhe.

Po duhej përballuar edhe nënçmimi ndaj tij i specialistëve dhe i jospecialistëve europianë, me të cilët kryemjeshtri shqiptar është ndeshur paprerë, sepse tek ata kishte shumë keqdashje, si edhe sharlatanëri, për të mos folur për paaftësi apo inkompetencë, pa harruar sabotimin. Duhej përballuar prestigji shpesh i rremë i të huajve.

Dhe duhej përballuar robëria e vërtetë në të cilën e ka mbajtur Petron zoti i tij, larg familjes, që jetonte në Korçë. Ne nuk dimë se në çfarë halli jetonte familja, pranë së cilës Petroja lejohej të shkonte rrallë. Ai zor se mund t'i vinte ndihmë, me që pashai s'e paguante. Petroja s'e kishte shpirtin të getë. Ndjenjat e tij antifeudale flasin edhe për vuajtjet e tij personale.

Merita e madhe e këtij njeriu, që duhet të ketë pasur energji të pashtershme, është se nuk qe vetëm i aftë t'i bënte ballë kopicës mal të punimeve, po qe se tipikisht shqiptar në artin e tij, si del nga një hetim i parë mbi ndërtimet që ai drejtoi. Arkitektura e Petro Korçarit qe autoktone. Për këtë çështje duhen bërë kërkime të veçanta, të cilat ia vlen të ndërmerren për një artist si Petroja dhe për një periudhë aq të rëndësishme ndërtimesh si periudha në të cilën

jetoi e veproji ai, koha e Ali Pashë Tepelenës. Kjo duhet bërë posaçërisht për të zbuluar se ç'ka sjellë të re ajo kohë në historinë e arkitekturës sonë, duke u nisur nga hipoteza e ligjshme, se një periudhë e tillë ndërtimesh aq të dëndura dhe të ndryshme e të mëdha, duhet të ketë sjellë kontributin e saj në mjeshtërinë dhe në artin shqiptar të ndërtimeve. Dhe atëherë do të mund të gjykohet edhe më mirë mbi arkitekturën shqiptare ashtu siç e njohim sot përmes disa modelesh që na kanë mbetur nga vitet midis shekujve XVIII e XIX, dhe do të depërtohet edhe më mirë në njohjen e ansambleve të mrekullueshme, arkitekturore, që janë qytete të tëra, si Berati e Gjirokastra. Çështja është me rëndësi të veçantë për njohjen e kulturës shqiptare në një aspekt ende pak të zbuluar të saj, në pragun e lëvizjes kombëtare shqiptare dhe në kohën e zgjimit të kulturës sonë të re.

Përpyekja në fushën e ndërtimeve gjatë një të trete shekulli të sundimit të Ali pashë tepelenës jep, në mënyrën e vet, një ide të potencës shqiptare të atyre viteve të zhvillimit të artizanatit e të tregtisë, të lindjes së borgjezisë, të krijimit të shteteve autonome dhe të forta feudale në Veri dhe në Jug të vendit. Sundimtarët e atyre dy shteteve synuan, secili, bashkimin e gjithë tokave shqiptare nën hegjemoninë e vet, aspiruan çlirimin e plotë nga perandoria osmane.

Me punën e tij si kryearkitekt dhe ndërtues, inxhinier Petro Korçari kontriboi për forcimin e shtetit të Ali pashës, si dhe për rritjen e prestigjit të sundimtarit nga Tepelena, për rritjen e prestigjit të shtetit të tij.

Petro Korçari, që ndërtoi për zotër feudalë të

ndikuar nga shijet e Orientit dhe në kuadrin e përgjithshëm të perandorisë osmane, ku ndikimi i kulturës turke e përgjithësisht orientale ishte i pashmangshëm në fushën e artit, nuk i është shmangur dot edhe ai çdo ndikimi. Sidoqoftë, vetë prejardhja shoqërore e kryearkitektit Petro, nga shtresat e reja të borgjezisë qytetare, me sa duket fshatar e oparak nga i ati, d.m.th. edhe murator, prej një mjedisi, pra, që ruante fort traditat e lashta vendëse dhe ecte sipas tyre, pastaj idetë e ndjenjat antif feudale dhe antitklerikale që ai ushqente, duhet të bënin që kryemjeshtri ynë t'i qëndronte, me sa mundet dhe sigurisht mirë, ndikimit të tepruar e të paasimiliuar mbi artin e tij të arkitekturës tradicionale shqiptare, dhe të dinte të merrte nga arkitektura e vendeve të tjera. Sidoqoftë, ndikimi që ai nuk mundi të mos pësonte nga arkitektura e Orientit, kur krijoi për zotër feudalë të ndikuar nga shijet orientale, duhet zbuluar e njohur, tek është dhe sa është, për të vënë në dukje mirë autoktoninë e artit të kryearkitektit shqiptar. Kjo do të kërkojë studime komplekse mbi ndërtimet që na kanë arritur prej periudhës në të cilën jetoi Petro Korçari dhe të objekteve dhe gjurmave të objekteve që kanë mbetur prej tij.

Petro Korçari, ky arkitekt me fat aq të rrallë, të cilit iu dha mundësia të ndërtonte aq shumë, që edhe një artist shumë fatkeq, sepse tepër pak gjëra, edhe ato jo sa duhet të identifikueshme, jetuan pas kryemjeshtrit. Tragjedia e këtij artisti bën pjesë në tragjedinë më të madhe të shembjes së shtetit që ngriti Ali pashë Tepelena. Se nuk duhet t'ia vëmë kaq fajin dobësisë së ndërtimeve të asaj kohe ngutjeje, po së pari dhe kryesisht furisë osmane, vandalizmit osman në përgjithësi. Ai vandalizëm ishte i li-

dhur me përpjekjen e pushtuesve për të shtypur qëndresën shqiptare, gjë që s'u arrit e që mori një zhvillim të ri, shumë më të përparuar, pas zhdukjes së Ali pashë Tepelenës e të Bushatasve.

Le ta mbyllim këtë studim me shpresën se ai do t'u shërbejë lexuesve për t'i shtuar diçka njohjes së kulturës kombëtare, prej një fushe pak të zbuluar të saj, siç është arkitektura, dhe specialistët të gjejnë në këto faqe një nxitje për kërkime të frutshme në një periudhë të rëndësishme të artit të ndërtimeve në Shqipëri, si dhe për një mjeshër të jashtëzakonshëm, kryearkitektin e Ali pashë Tepelenës, inxhinier Petro Korçari.

VII. SHËNIME

- 1) *Një arkitekt i shquar shqiptar, Petro Korçarin* (gaz. «Drita», Tiranë 31.I.1977, f. 12).
2. W. M. Leake, *Travels in Northern Greece*, London 1835, vëll. I, f. 223: «July 1 — This afternoon I set out on a tour to Suli, accompanied by the Italian renegade Mehmet Efféndi, together with one of Vezir's trusty Albanian bolucbashis, and his chief architect named Peter of Korytzà, who constructed the brigde and serài at Tepeleni, and has built many other of the Pashà's palaces and castles.» F. 229: «The fortress in the middle of Mount Trypa, which the Vezir began to build as soon as he obtained possession of Suli, is now nearly finished: my companion Kyr Peter, of Korytzà, is the architect. The crest of the ridge is so narrow, that there is just room for a path, and Kyr Petros was obliged to level the hill before he began the castle.» F. 253: «My travelling companion, Kyr Petros, of Korytzà, considers Captain Ianàki an object of envy; and with reason, — for although Peter is the Vezir's chief architect an engineer, he has served in his present capacity for five years without receiving a parà, although constantly employed in superintending the building of some castle serài, for the Vezir or his sons. His property and family (f. 254) are at Korytzà, where by special favor he is now and then allowed to stay a few days. He relates that when he was excavating the ground for the new serài in the castle of Ioànnina, a stone was found inscribed in honour of Thomas Ἡγούμενος, benefactor of Ioannina. Having reported his discovery to the Vezir, his highness said, «Go read all the old histories, and come to-morrow morning and let me know whose monument is.» This some benefactor of Ioànnina is sad to have been a much worse tyrant

than Aly himself; and one among several examples which show that many of the Christian chieftain of Albania and Servian race, with their military followers exercised a dominion over the subject population of Greece not less oppressive than the Turkish. Kyr Petros states that his native town and the neighbouring one of Moskhopoli formerly contained five or six thousand houses, but that the emigrations which reduced them to less than eight hundred. The distress of the Christian population throughout the diocese of Ioannina, he ascribes in great measure to the extravagance of the bishop...».

- 3) V. sh. 2,
- 4) Shih: *Historia e Shqipërisë*, bot. i Universitetit të Tiranës, Tiranë 1959, vëll. I, f. 431-4, 446-9, 454-78.
- 5) Japim ndonjë shembull: F. C. H. L. Pouqueville, *Voyage en Morée, à Constantinople, en Albanie et dans plusieurs autres parties de l'empire Ottoman, pendant les années 1798, 1799, 1800 et 1801*, Paris 1805, vëll. III, f. 35: Janina «kryeqytet i Shqipërisë». Po ai, *Voyage dans la Grèce*, Paris, 1820, vëll V, f. 182-3, jep marrëveshjen e bërë midis Veli pashës, djalit të Ali pashë Tepelenës, dhe suliotëve, më 12.XII.1803, për pushimin e luftës. Teksti është greqisht dhe aty shteti i Ali pashës quhet Albavna. G. de Vaudoncourt, *Memoirs on the Jonian Islands, ... including the life and character of Ali pascha*, London 1816, f. 25: «Shqipëria, një provincë kaq independente e Turqisë sikundër është sot»; është fjala për zotërimet e Ali pashës. T. S. Hunges, *Voyage à Janina en Albanie*, Paris, 1821, vëll. II, f. 233: «gjendja e banorëve të Shqipërisë përpara konsolidimit të pushtetit të Aliut (...). Në Shqipëri (..) turku, greku dhe shqiptari janë njësoj të mbrojtur». Është fjala për shtetin e Aliut. Pouqueville, *Voyage en Morée*, vëll. III, f. 342, e quan qytetin e Greqisë Trikala «qytet të Shqipërisë», sepse vendi sundohej nga Ali pasha.
- 6) *Histori e Shqipërisë*, vëll. I, f. 447.
- 7) Pouqueville, *po aty*, f. 127.
- 8) F. C. H. L. Pouqueville, *Histoire de la régénération de la Grèce*, bot. Bruxelles 1843, vëll. I, f. 100.

- 9) Hughes, *Voyage*, vëll. I, f. 181. Prevezën Aliu nuk e mbajti dot dhe ia dorëzoi sulltanit, porse, në fakt, ai sundoi aty më shumë vetë, kështu që fortifikimet i shërbenin pushtetit që ai po rriste.
- 10) Hughes, vëll. I, 181; Ibrahim-Manzour-Effëndi, *Mémoires sur la Grèce et l'Albanie*, Paris 1827, f. 53.
- 11) Manzour, *Mémoires*, f. III, dhe 36, 263-64.
- 12) Po ai, f. 91, 252-3.
- 13) Pouqueville, *Voyage de Grèce*, bot. 2, Paris 1826, vëll. II, f. 271.
- 14) Manzour, f. 316-28.
- 15) Po ai, f. 261; Pouqueville, *Voyage de Grèce*, vëll. I, f. 213-4.
- 16) Hughes, vëll. I, f. 184-5.
140.
- 17) V. ndër të tjerë, Pouqueville, *po aty*, bot. 2, vëll. I, f.
- 18) Hughes, vëll. I, f. 181-83; Manzour, f. 53.
- 19) Pouqueville, *Voyage de Grèce*, vëll. II, f. 92; po ai, *Régénération de la Grèce*, bot. Bruxelles, vëll. I, f. 100; Hughes, vëll. I, f. 239, etj.
- 20) Hughes, *po aty*, f. 279, 284-5, 288-9.
- 21) H. Holland, *Travels in the Jonian Isles, Albania, Thesaly*, London 1819, vëll. II, f. 307-8.
- 21a) Ali pasha, p.sh., ka përdorur mjeshtrit vllahë të Mecovës (Pouqueville, *Voyage de Grèce*, vëll. I, f. 231).
- 22) Manzour, f. XXXV.
- 23) Pouqueville, *po aty*, f. 118.
- 24) J. W. Bagally, *Ali pascha and the Great Britain*, Oxford 1938, f. 43.
- 25) V. sh. 2.
- 26) Pouqueville, *Régénération de la Grèce*, bot. Bruxelles, vëll. I, f. 71: «Mastro-Pietro, Albanais, qui était son Vauban, a (...) construit plus de tours dans l'Epire, que jamais Paul Emile n'y renversa de villes.»
- 27) Vandoncourt, f. 287: «...his fortifications, generally directed by his selictar, and by an Albanian of the name of Peter, one as obstinate and ignorant as the other.»
- 28) Hughes, vëll. I, f. 279, 284-5, 288-9.

- 29) *Histori e Shqipërisë*, vëll. I, f. 230-1, 242
- 30) Mund të jetë fjala për selihdarin (adjutant) e Ali pashës, Ismail Podën, i njohur si Zylyftar Poda. Aliu e kishte vënë kështu ndërtimet e tij ushtarake nën mbikqyrjen e një njeriu të tij nga më të besimit.
- 31) Vaudoncour, f. 287.
- 32) *Po aty*.
- 33) Pouqueville, *Voyage de Grèce*, vëll. II, f. 41.
- 34) J. G. Hobhouse, *A journey through Albania and other provinces of Turkey in Europe and Asia to Constantinople*, during the years 1809 and 1810, London 1913, f. 178.
- 35) Holland, vëll. II, f. 307.
- 36) *Po aty*, f. 308.
- 37) Pouqueville, *Voyage de Grèce*, vëll. II, f. 41. Nën drejtimin e Petro Korçarit janë ngritur, me sa duket, edhe ndërtesa jo vetëm të kultit të krishterë, si kisha në Porto-Palermo (*po aty*, vëll. I, f. 55), por edhe mysliman, si një xhami në Prevezë, në vitin 1807 (Manzour, f. 195), dhe një tjetër në Tepelenë, përpara vitit 1809 (Holland, vëll. II, f. 307).
- 37a) Në Tepelenë, Përmet e gjetiu, Petroja mund të ketë shfrytëzuar çka mund të kishte mbetur nga fortifikatat e hershme. Kjo vlen të hetohet mirë. Po shpesh prej kalave të vjetra s'kishte mbetur gati asgjë që të shërbente. V. Çka thotë, p.sh., Pouqueville, *Voyage en Morée*, vëll. III, f. 95, 98-9, për kalatë e Gumenicës dhe Prevezës.
- 38) *Po aty*, vëll. I, f. 229-30.
- 39) *Po aty*,
- 40) Hobhouse, f. 178-9.
- 41) Hughes, vëll. I, 178-9.
- 42) audoncourt, f. 277; Pouqueville. *Voyage en Morée*, vëll. III, f. 49.
- 43) A. Boppe, *L'Albanie et Napoléon (1797-1814)*, Paris 1914, f. 51.
- 43a) Pouqueville, *Voyage en Morée*, vëll. III, f. 40.
- 44) *Po ai*, *Voyage de Grèce*, vëll. I, f. 90-3.
- 45) A. Boué, *La Turquie d'Europe*, Paris 1840, vëll. II, f.

241. Që më 1820, ushtria turke, që rrethoi Janinën, kishte mundur të bëjë një të çarë në kalanë e Litharicit. Ajo e sulmoi kalanë në pranverë 1821, po s'e mori dot. Litharici u dorëzua pak më përpara se Aliu të vritej (G. Remerand, *Ali pasha Tepéléni*, Paris 1928, f. 264). Pouqueville, *Régénération de la Grèce*, bot. Bruxelles, vëll. II, f. 160, tregon se si Ali pasha bombardoi dhe do-gji pallatin e Myftarit, të birit, të cilin e kishte pushtuar armiku gjatë luftës së viteve 1820-22.
- 46) Boppe, f. 169.
- 46a) Hughes, vëll. I, f. 202. Një përshkrim të hyrjes në pallat, të kapërcimit nëpër katin e parë dhe të sallës së ceremonive ka bërë edhe Holland f. 121-3.
- 47) *Po aty*, f. 221. Për «stilin turk» të tyre flet edhe Holland, f. 121.
- 48) Pouqueville, *Voyage de Grèce*, vëll. I, f. 118-9.
- 49) *Po aty*, bot. 2, vëll. I, f. 110.
- 50) Mbi pikturimet e pallateve të Ali pashës e të djemve të tij, v. *po aty*, bot. 1, f. 81, 118-9; Hobhouse, f. 36, 110
- 51) Hobhouse, f. 69
- 52) Hughes, vëll. I, f. 223.
- 53) Pouqueville, *Voyage en Morée*, vëll. III, f. 49-75.
- 53a) *Po aty*, f. 25.
- 54) Po ai, *Voyage de Grèce*, bot. 2, vëll. II, f. 16; vëll. I, f. 222.
- 55) Hughes, vëll. I, f. 175, 178-80; Hobhouse, f. 110.
- 56) Pouqueville, *Régénération de la Grèce*, bot. Bruxelles, vëll. II, f. 153.
- 57) Hobhouse, f. 79; Vaudoncourt, f. 277; Pouqueville, *Voyage on Morée*, vëll. III, f. 34.
- 58) Pouqueville, *Po aty*, f. 45; dhe *Voyage de Grèce*, bot. 2, vëll. I, f. 121, 163-5.
- 59) *Po aty*, bot. 1, f. 84.
- 60) *Po aty*, f. 81.
- 61) V. sh. 15.
- 62) *Po aty*, f. 79.
- 63) *Po aty*, bot. 2, f. 174.

- 64) *Po aty*.
- 65) Hobhouse, f. 79.
- 66) Pouqueville, *Voyage de Grèce*, bot. 2, vëll. II, f. 55.
- 67) Hobhouse, f. 39-40; i pëlqeu më shumë se pallati i Prevezës, ku ishte strehuar bashkë me Bajronin. Pouqueville, *Voyage de Grèce*, vëll. II, f. 99.
- 68) *Po aty*, bot. 2, vëll. II, f. 267, sh. 1.
- 69) *Po aty*, bot. 1, vëll. I, f. 66:
- 70) *Po aty*, f. 67.
- 71) *Po aty*, f. 55. Autori përmend edhe kishën e Porto-Palermos dhe magazinat, të ndërtuara në të njëjtën kohë me fortesën. Për ngutin me të cilin u ndërtua fortesa fill pas pranverës së vitit 1798, flet Manzour, f. 30-1.
- 72) Hobhouse, f. 107; Pouqueville, *Régénération de la Grèce*, bot. Bruxelles, vëll. I, f. 92, mbi sulmin kundër francezëve në Butrint, në shkurt 1798; Manzour, f. 37.
- 73) Ali pasha kishte ndërtuar fortesa të vogla ose kulla, që i njohin në këmbë më 1806, p.sh. në vende si Suli, Muzina, Butrinti (pranë daljes së kanalit në det).
- 74) Zor të përcaktojmë kohën e ndërtimit të disa haneve nga Ali pasha, si ata të Lavenit, pranë Filatit (Pouqueville, *Voyage de Grèce*, bot. 2, vëll. II, f. 105; autori e ka parë më 1813); të Lorit, që ishte i madh e fort i bukur, me paraqitjen e një pallati (*po aty*, bot. I, vëll. II, f. 37); të Pesë Puseve (Hughes, vëll. I, f. 189-90; — po ky bën një përshkrim të hanit të Lorit dhe është larg shumë lëvdatave të Pukvilit; f. 71-2).
- 75) Pouqueville, *po aty*, vëll. II, f. 27. një bankinë në Prevezë.
- 76) *Po ai*, *Voyage en Morée*, vëll. III, f. 127; Manzour, f. 266.
- 77) Pouqueville, *Voyage de Grèce*, vëll. II, f. 92, kanali i Lurit, që u bë i lundrueshëm dhe lidhej me detin në gjirin e Prevezës; ai lehtësonte transportin e mallrave për Janinë.
- 78) Pouqueville, *po aty*, flet për rrugën e Kanopullit dhe të Afilokisë, ku filloi ndërtimi më 1810 dhe mbaroi katër vjet më pas; Hughes, vëll. I, f. 184-5, flet për rrugën Sallagorë-Artë, gjatë bregut të detit, dhe e cilëson ai më të mirën që ai kishte njohur gjer atë kohë

- në viset që vizitoi; ishte punë e një mjeku italian, të cilin e quan «inspektor të rrugëve të mëdha të zotit të Shqipërisë» (v. dhe sh. 16).
- 79) V.sh. 16 dhe 80.
 - 80) Pouqueville, *Voyage de Grèce*, bot. 2, vëll. III, f. 56. Autori e paraqit Xheladin beun, sundimtarin e Ohrit dhe nip të Ali pashës, si një njeri që bëri të ndërtohen shumë ura.
 - 81) V. sidomos «Monumentet», Tiranë 1971-5 dhe «Etnografia shqiptare», Tiranë 1962-76, për arkitekturën tonë qytetare dhe atë të fshatit. Më interes të veçantë ishin punimet e Sesionit shkencor të Institutit të ruajtjes dhe konservimit të Monumenteve, mbajtur në Tiranë në dhjetor 1976.
 - 82) Pouqueville, *Régénération de la Grèce*, bot. Bruxelles, vëll. II, f. 100.
 - 83) Manzour, f. 2.
 - 84) Po ai, f. 111.
 - 85) Hughes, vëll. I, f. 175.
 - 86) *Po aty*, f. 216.
 - 87) *Po aty*.
 - 88) Hobhouse, f. 68.
 - 89) Po ai, f. 39-40.
 - 90) Po ai, f. 68; Hughes, *po aty*, f. 393-4.
 - 91) *Po aty*, f. 202.
 - 92) *Po aty*, f. 193. Përshkruan shtëpinë e janinotit Petro Argjiri, ku pati ndenjur edhe Bajroni.
 - 93) *Po aty*, f. 258-9.
 - 94) Hobhouse, f. 110-1.
 - 95) Vaudoncourt, f. 287.
 - 96) Hughes, vëll. I, f. 185.
 - 97) *Po aty*, f. 183, 239. Hjujz, që nuk besonte në yllin e Ali pashës, shkruan për rrugën Sallagorë-Artë, të cilën e pëlqeu fort (v. sh. 80): «është e vështirë të thuash se kush do të bjerë më parë në harresë, pashai apo rruga».
 - 98) Manzour, f. 135.
 - 99) Në shumë vende, edhe në Tepelenë e Përmet, edhe në Prevezë e Artë, p.sh., ndërtimet u bënë duke shfrytëzuar edhe çka kishte mbetur nga kështjellat mesjetare ose të kohës së Turqisë. V. dhe sh. 37.

100) Vaudoncourt, f. 287.

101) Manzour, f. 214-5; v. dhe Pouqueville, *Régénération de la Grèce*, bot. Bruxelles, vëll. II, f. 100; *po aty*, f. 61, data jepet gabim 1818. Mbi materialet e ndërtimit dhe mbi krahun e punës, v. sidomos Manzour, f. 135. Poky, f. 308, tregon se, për nevojat e ndërtimeve, Aliu i kishte prerë gjithë drurët në afërsitë e Janinës, kështu që çmimi i drurit e i thëngjillit në Janinë ishte më i lartë se në çdo qytet tjetër të perandorisë, për shkak të largësisë prej ku ata vinin. Kur ish e mundur, transporti i drurit të ndërtimit bëhej me anë të lumenjve; Pukvili pa në Vjosë lëndën që vinte në Përmet për ndërtimet e atyshme të kështjellës e të pallatit (*Voyage de Grèce*, bot. 2, vëll. I, f. 218). Mbi përdorimin e materialit të qyteteve të rrënuara antike, sidomos të mermerit, v. Hughes, vëll. I, f. 180.

102) V. sh. 26.

VIII. BIBLIOGRAFIA

- Bagally, J. W. *Ali pascha and the Great Britain*, Oxford 1938.
- Boppe, A. *L'Albanie et Napoléon (1797-1814)*, Paris 1914.
- Boué A. *La Turquie d'Europe*, Paris 1840.
- Etnografia shqiptare*, Tiranë 1962-76 (shtatë numëra).
- H. H. Një arkitekt i shquar shqiptar, Petro Korçari (gaz. «Drita», Tiranë 31. I. 1977, f. 12).
- Historia e Shqipërisë*, bot. i Universitetit të Tiranës, Tiranë 1959, vëll. I.
- Hobhouse, J. C. A. *journey through Albania and other provinces of Turkey in Europe and Asia to Constantinople, during the years 1809 and 1810*, London 1813.
- Holland, H. *Travels in the Jonian Isles, Albania, Thessaly, Macedonia*, London 1819.
- Hughes, T. S. *Voyage à Janina en Albanie*, Paris 1821.
- Ibrahim-Manzour-Effendi. *Mémoires sur la Grèce et l'Albanie*, Paris 1827.
- Leak, W. M. *Travels in Northern Greece*, London 1835.
- Monumentet*, Tiranë 1971-5 (dhjetë numëra).
- Pouqueville, F. C. H. L. *Voyage en Morée, à Constatinople, en Albanie et dans plusieurs autres parties de l'empire Ottoman, pendant les années 1798, 1799, 1800 et 1801*, Paris 1805.
- Po ai. *Voyage dans la Grèce*, Paris 1820; bot. 2, po aty 1826.
- Po ai. *Histoire de la régénération de la Grèce*, Paris 1826; bot. Buxelles 1843.
- Remérand, g. *Ali pascha Tépéléni*, Paris 1928.
- Vaudoncourt, G. de. *Memoirs on the Jonian Islands (...)* including the life and character of Ali Pascha, London 1816.

PASQYRA E LËDËS

	Faqe
I. Hyrje	3
II. Ali pashë Tepelena, — koha e tij dhe pasioni i tij për ndërtimet	5
III. Jeta e Petro Korçarit	13
IV. Ndërtimet e Petro Korçarit si kryearkitekt i Ali pashë Tepelenës	24
V. Vështrim i përgjithshëm mbi punën e kryearki- tektit inxhinier Petro Korçari	35
VI. Përmbyllje	48
VII. Shënime	54
VIII. Bibliografi	62
Pasqyra e lëndës	63